



Durres Port Authority 

**Republika e Shqiperise
Ministria e Puneve Publike dhe Transportit**

DHE

Albanian Ferry Terminal Operator Shpk

**(FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft MBH dhe Global
Networks Albania Shpk)**

**KONTRATE KONÇESIONI PËR
MENAXHIMIN, OPERIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E TERMINALIT TË
TRAGETEVE TË PORTIT TË DURRËSIT**



TABLE OF CONTENTS

PREAMBLE	7
DEKLARIME PARAPRAKE.....	7
NENI 1 PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME.....	9
1.1 Përkufizime	9
1.2 Interpretime.....	15
2. NENI 2 KONÇESIONI	17
2.1 Objekti i Konçesionit	17
2.2 Terminali dhe Zonat e Konçesionit.....	17
2.3 Përpunime te tjera.....	19
2.4 Pranimi i Konçesionit	19
2.5 Periudha e Konçesionit	20
2.6 Deklarime dhe garanci të palëve.....	21
3. NENI 3 ANGAZHIME TË PALËVE	25
3.1 Palët në këtë Kontratë marrin përsipër dhe bien dakord si më poshtë:.....	25
4. NENI 4 SIGURIMI I KONTRATËS.....	28
5. NENI 5 PRONËSIA INTELEKTUALE	29
6. NENI 6 NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT DHE PËRFAQESIMI I PALËVE	30
7. NENI 7 DATA EFEKTIVE.....	31
8. NENI 8 ÇESHTJE FINANCIARE DHE TË PAGESËS	31
8.1 Vlera e Kontratës së Konçesionit	31
8.2 Vlera e të ardhurave te Konçesionarit	31
8.3 Pagesa e Konçesionit	32
8.4 Mbledhja e te ardhurave nga Konçesionari	35
8.5 Tarifat e Shërbimit.....	36
8.6 Vlera e Investimit	36



8.7	Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve.....	37
8.8	Financimi i Konçensionit	37
9.	NENI 9 SHOQËRIA KONÇESIONARE	37
10.	NENI 10 NËNKONTRAKTIMI DHE TRANSFERIMI I TË DREJTAVE	38
10.1	Nënkontraktimi.....	38
10.2	Transferimi i të drejtave.....	39
11.	NENI 11 SIGURIMI.....	39
11.1	Kërkesat për sigurimin	39
11.2	Prova e mbulimit me sigurim.....	40
11.3	Vlefshmëria e mbulimit me sigurim.....	40
11.4	Bashkëpërfituesi në siguracione	40
11.5	Moskryerja apo mosrinovimi i siguracionit.....	40
12.	NENI 12 SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBATJA E KONÇESIONIT	41
12.1	Detyrimet e Konçesionarit.....	41
12.2	Të drejtat e Koncesionarit	46
12.3	Shërbimet	47
13.	NENI 13 TE DREJTA, DETYRA DHE DETYRIME TE PËRGJITHSHME	47
13.1	Të Konçesionarit.....	47
13.2	Të Autoritetit Kontraktor dhe/ose Autoritetit Portual Durrës.....	49
13.3	Detyrimi për bashkëpunim dhe respektim të të drejtave.....	51
14.	NENI 14 dëmshpërblimi.....	51
15.	NENI 15 konfidencialiteti.....	52
16.	NENI 16 FORCA MADHORE	53
17.	NENI 17 KUFIJTË E PENALITETEVE.....	54
18.	NENI 18 zgjidhja e kontratës	54



18.1	Rastet e Mospërbushjes	54
18.1.1	Rastet e Mospërbushjes nga Konçesionari.....	54
18.1.2	Rasti i Mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose APD	55
18.1.3	Te drejtat e palëve në rast mospërbushje.....	56
18.2	Proçedura e Zgjidhjes së Kontratës	56
18.2.1	Zgjidhja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues	56
18.2.2	Plani i rregullimit.....	56
18.2.3	Ndreqja nga Autoriteti Kontraktor	57
18.2.4	Zgjidhja e Kontratës nga Konçesionari	57
18.2.5	Pagesat e Zgjidhjes së Kontratës	57
18.3	Përfundimi i Kontratës për shkak të Forcës Madhore	59
18.4	Njoftimi i përfundimit	60
18.5	Transferimi i kompetencave te Autoriteti Kontraktor dhe te Autoritetit Portual të Durrësit.....	60
18.6	Zëvendësimi i Koncesionarit	60
18.7	Zgjidhja e Kontratës për dështim/mospërbushje nga Autoriteti Kontraktor....	61
18.8	Detyrime gjatë periudhës së përfundimit	61
18.9	Pasoja të tjera të përfundimit.....	61
19.	NENI 19 TRANSFERIMI I TTD PAS PËRFUNDIMIT TE PERIUDHËS SË KONÇESIONIT	61
19.1	Transferimi i TTD	61
19.2	Transferimi i vonuar	62
19.3	Rrisku	63
20.	NENI 20 MJETET E RIPARIMIT/DËMSHPERBLIMIT KUMULATIVE	63
21.	NENI 21 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	63
22.	NENI 22 DISPOZITA TË NDRYSHME	63



22.1	Vazhdimesia e detyrimeve	63
22.2	Detyrimet te vecanta	64
22.3	Pavarësia e dispozitave	64
22.4	Ndryshimet e Kontratës.....	64
23.	NENI 23 NJOFTIMET	64
24.	NENI 24 KOPJE DHE GJUHA E KONTRATES	65
	ANEKS 1 DOKUMENTAT STANDARTE TE PROCEDURES KONKURUESE.....	66
	ANEKS 2 OFERTA E KONCESIONARIT	67
	ANEKS 3 FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES.....	68
	ANEKS 4 ZONA E TERMINALIT.....	69
	ANEKS 5 TARIFAT E SHERBIMIT	73
1.	TARIFAT E PORTIT DHE KANALIT	74
1.1	Tarifat e Portit dhe kanalit	74
2.	TARIFAT E AKOSTIMIT	74
2.1	Tarifat e kalates/vendakostimit	74
3.	TARIFAT E PERPUNIMIT	74
3.1	Perkufizime te tjera per Imbarkimin/Disimbarkimin e Pasagjereve	74
3.2	Tarifat e imbarkimit/disimbarkimit te pasagjereve me tragete.....	75
3.3	Perkufizime të tjera per perpunimin Roll-on/Roll-off te ngarkesave	76
3.4	Tarifat e përpunimit të automjeteve (Mallra Ro/Ro)	77
3.5	Tarifat e Parking-ut	78
	ANEKS 6 MARREVESHJA E TRANSFERIMIT Të ASETETEVE.....	80
	ANEKS 7 TRANSFERIMI I PUNONJESVE AKTUAL TE TTD.....	85
	ANEKS 8 PENALITET E KONTRATES.....	86
1.1	Penalitetet e zbatueshme në rast vonese	86



ANEKS 9 ORTAKET THEMELUES	89
---------------------------------	----



PREAMBLE

- 1) **KJO KONTRATË KONÇESIONI** për dhënien në koncesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të Terminalit të Trageteve në Portin e Durrësit lidhet sot më datë 22 gusht 2013 në Tiranë, midis:
- a) **MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT e Republikës së Shqipërisë, (MPPT ose Autoriteti Kontraktor)** që vepron në përputhje me Ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar,; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 546, date 28.05.2009 "Për miratimin e Masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 "Mbi miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve" i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 03.04.2013, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktor "Për dhënien me koncesion të menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Terminalit të Trageteve në Portin e Durrësit"

DHE

- b) **ALBANIAN FERRY TERMINAL OPERATOR SH.P.K (AFTO ose Konçesionari)** një kompani konçesionare e dedikuar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me nr identifikimi L31817505L, themeluar sipas ligjeve të Repuplikës së Shqipërisë nga bashkëpunimi i kompanive:
- i **FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft MBH** një kompani me përgjegjesi të kufizuar, e organizuar dhe themeluar ne vitin 1992 sipas ligjit gjerman, regjistruar në gjykatën tregtare të Stralsund, Gjermani me numër regjistrimi HRB 2312, me adresë zyrtare në Achtern Diek 4, 18565 Hiddensee OT Vitte, Germany.
- ii **Global Networks Albania sh.p.k** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë më datë 06.12.2010, me nr të identifikimit L 02414010M, me adresë Tiranë, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Aba Bussines Center kati 14 zyra 1405/2.

DEKLARIME PARAPRAKE

- 1) Autoriteti Kontraktor ka autoritetin të nënshkruaje këtë kontratë në përputhje me:
- Ligjin nr. 9663, date 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar;
 - Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 27 datë 19.01.2007 "Mbi miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve" i ndryshuar;
 - Veëndimi i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 03.04.2013, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktor "Për dhënien me koncesion të menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Terminalit të Trageteve në Portin e Durrësit;
 - Ligji nr. 9251 datë 8.06.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqiperisë", i



ndryshuar;

- Ligji nr. 9130 date 8.9.2003 "Per Autoritetin Portual";
 - Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 546, date 28.05.2009 "Për miratimin e Masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit";
 - Kërkesën për Propozim dhe Udhëzimet për Ofertuesit, (Dokumentat e Tenderit) me anë të të cilave MPPT ka ftuar ofertuesit të paraqesin ofertat e tyre për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të Terminalit të Trageteve në Portin e Durrësit;
 - Legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- 2) Më datë 20.06.2013 ora 14:00, Koncesionari ka dorëzuar propozimin e tij në përputhje me procedurën e tenderit (Oferta e Koncesionarit) që është pranuar nga Autoriteti Kontraktues.
 - 3) Më datë 19.07.2013 Autoriteti Kontraktor ka dërguar Koncesionarit "Njoftimin e Fituesit" shkresa nr. () prot datë 19.07.2013 dhe Koncesionari ka konfirmuar pranimin e njoftimit dhe vazhdimin e procedurave;
 - 4) Negociatat per Kontratën Koncesionare filluan më datë 12.08.2013.
 - 5) Kjo Kontratë Koncesionare do të hyjë në fuqi me firmosjen nga Palët (Data Efektive).
 - 6) Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari angazhohen në mirëbesim të vënë në zbatim këtë Kontratë Koncesioni, në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara më poshtë;
 - 7) Në realizimin e Kontratës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare merr pjesë së bashku dhe në menyrë solidare me kompanitë themeluese FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft MBH dhe Global Networks Albania sh.p.k.

NE VIJIM SI MË LART, Palët bien dakord si më poshtë:



NENI 1 PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Kurdoherë që fjalët me gërmën e parë të madhe do të përdoren në këtë Kontratë (duke përfshirë edhe Anekset e saj) këto fjalë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“**Aneks**” do të thotë çdo dokument, bashkëlidhje apo shtojcë e kësaj Kontrate, që formon një pjesë integrale dhe të pandarë të saj.

“**Anije**” do të quhen dhe përfshihen anijet e destinuara për transport pasagjerësh, për transport Ro/Ro dhe/ose të kombinuar, Kroçeret, anijet turistike, jachte, mjetet e vogla lundruese për pasagjerë.

“**Autoritet Kontraktor**” do të thote Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Republikës së Shqipërisë ose shkurt “MPPT” si dhe çdo institucion tjetër të cilit mund t’i kalojnë në kohë të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.

“**Autoriteti Portual Durrës ose APD**” do të thotë personi juridik i cili perfaqëson interesin publik dhe administron pronën publike të Portit të Durrësit, i krijuar sipas ligjit 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij”.

“**Check in Elektronik**” do të thote sistemi informatik i zbatuar dhe i operuar nga Autoriteti Portual, i ndërtuar në përputhje me standartet ISPS për rritjen e sigurisë në Autoritetin Portual, kontrollin e lëvizjeve të imbakimit dhe transit të mjeteve dhe të pasagjerëve si dhe për rritjen e përgjithshme të cilësise së shërbimit brenda APD, i cili është në detyrimet e Konçesionarit sipas kësaj kontrate.

“**Data Efektive**” është data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

“**Data e Fillimit të Operimit**” do të thotë data në të cilën Konçesionari fillon operimin në TTD, e cila nuk do të jetë më vonë se 150 ditë nga Data Efektive.

“**Dokumentat e Tenderit (DT)**” do të thotë dokumentat e procedurës së konçesionit të shpallura nga Autoriteti Kontraktor me objekt, dhënien me konçesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmiresimit teknik të Terminalit të Trageteve, sipas VKM nr nr. 271, datë 03.04.2013, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktor “Për dhënien me konçesion të menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Terminalit Trageteve në Portin e Durrësit”.



“Periudha Parapërgatitore” do të thotë periudha nga Data Efektive deri në Datën e Fillimit të Operimit.

“Data e Paraqitjes se Ofertes” do të thotë data dhe ora, në të cilën ofertuesit kanë paraqitur ofertat e tyre, për këtë konçesion në përputhje me Udhëzimet për Ofertuesit.

“Ditë Pune” do të thotë një ditën gjatë të cilës në Republikën e Shqipërisë punohet me përjashtim të të dielave dhe festave zyrtare.

“E Drejta e Kalimit” do të thotë e drejta për të kaluar në port dhe në çdo pjesë të tij si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate.

“Entitet Shtetëror” do të thotë (i) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe/ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike dhe administrative e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose instancë gjyqësore ose çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, si dhe çdo komunë ose bashki, dhe që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Konçesionarin, ose çdo autoritet i pavarur rregullator, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor përjashtohet nga ky përkufizim.

“Forcë Madhore” ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 14.

„Konçesion“ do të thotë marrëveshja për konçesionin e shërbimeve dhe punëve sipas kësaj kontrate.

“Kontratë Konçisioni” ose “Kontratë” “Marrëveshje” do të thotë kjo Kontratë e shkruar, e lidhur mes Palëve (dhe të gjitha Anekset e saj të cilat do të konsiderohen pjesë përbërëse e pandashme e saj) dhe dokumentat bashkëngjitur kësaj Kontrate ose Anekseve të saj pavarësisht emërtimeve që u jepen në vijim të negociatave mes Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.

“Konçisionar” do të thotë Shoqëria Konçisionare Albanian Ferry Terminal Operator sh.p.k , regjistruar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me nr regjistrimi L31817505L themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë nga bashkëpunimi i kompanive FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft MBH dhe Global Networks Albania referuar Nenit 9 të kësaj Kontrate, ose çdo person juridik tjetër në kohë të cilit mund t'i kalojnë të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.



“Leje, Autorizim, Liçensë” do të thotë çdo miratim, leje, liçensë, autorizim, aprovim ose certifikate, nxjerrja ose ripërtëritja e secilës është në përgjegjesinë e një Entiteti Shtetëror dhe që kerkohet për zbatimin e kësaj Kontrate.

“Ligj” do te thotë çdo ligj, akt nënligjor, dekret, Vendim i Këshillit të Ministrave apo çdo rregullore tjetër, urdhër, liçensë, leje, autorizim, vendimet unifikuese të gjykatave, me ndryshimet që mund të pësojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, i zbatueshem në Republikën e Shqipërisë.

“Normë Inflacioni” do te thotë norma zyrtare e inflacionit sipas përlogaritjeve të Institutit të Statistikave të Republikës së Shqipërisë “INSTAT”-it.

“Njoftimi për Zgjidhjen” në lidhje me Autoritetin Kontraktor ose Konçesionarin, sipas rastit, do të thotë një njoftim i njerës Palë drejtuar Palës tjetër që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate, sipas rastit, në vijim: (i) të një Rasti Mospërbushjeje nga Konçesionari ose të një Rasti Mospërbushjeje nga Autoriteti Kontraktor , i cili nuk është përmbushur brenda kuadrit kohor të parashikuar në këtë Kontratë, (ii) të Forcës Madhore, ose (iii) të çdo rasti tjetër të parashikuar shprehimisht në këtë Kontrate, i cili do të specifikojë shkakun e zgjidhjes dhe zgjidhja do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kontratë.

“Objekti i Konçesionit” do të thotë objekti i dhënë me Koncesion sipas kësaj Kontrate dhe Anekseve të saj.

“Oferta e Konçesionarit” ka kuptimin e parashikuar ne pikën 2 të Deklarimeve Paraprake të kësaj Kontrate.

“Palë” do të thote secili nga Autoriteti Kontraktor, Konçesionari, FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft MBH dhe Global Networks Albania sh.p.k, që do të referohen individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”.

“Përdorues i portit është çdo person fizik apo juridik i cili përdor infrastrukturën dhe merr shërbimet e Portit ose të terminalit, nga Konçesionari apo APD si të jetë rasti.

“Periudhë Konçesionare” do te thotë kohezgjatja prej 25 (njëzet e pesë) vjetësh duke filluar nga Data Efektive, siç përcaktohet në Nenin 2.5.

“Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor” do të thotë çdo përfaqësues që mund të caktohet herë pas here nga Autoriteti Kontraktor për ta përfaqësuar në lidhje me kryerjen e ndonjë prej të drejtave të tij sipas kësaj Kontrate, me kusht që, nëse do të lindë në vijim nevoja, Autoriteti Kontraktor të njoftoje menjëherë Konçesionarin për



çdo mbarim mandati, zëvendësim ose ndërrim përfaqësuesi.

“Përmiësim Teknik” do të thotë zhvillimi dhe përmiësimi ose modernizimi teknik i infra- dhe superstrukturës së TTD që gjithësesi përfshin edhe financimin në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë me qëllimin për të arritur kërkesat e tanishme dhe të ardhshme të përdoruesve të portit në fasilite, produktivitet, efikasitet dhe kosto efektive lidhur me trafikun e anijeve dhe ngarkesave.

“Praktikë e Industrisë së Mirë” do të thotë praktikën, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në shërbimet, ndërtimit, rehabilitimit, dhe operimit të Konçesionit të terminalit portual, konçisioni i cili pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një kontraktor i aftë dhe me eksperiencë në rrethana të njëjta ose të ngjashme me praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standardet Shqiptare dhe Evropiane (cilado qofshin më të larta, nga një periudhë kohore në tjetrën).

“Port” do të thotë Porti i Durrësit në qoftë se nuk është shprehur ndryshe.

“Produktiviteti Brutto” “Gross Productivity” janë normat e produktivitetit të imbardhimit/disimbardhimit të mjeteve ose mallrave për njësi nga një brigadë pune në njësinë e kohës të shprehura në ton ose nr mjetesh në turn apo orë.

“Master Plan” do të thotë studimi mbi “Përcaktimi/azhurnimi i Master Planit për Portin e Durrësit” hartuar nga konsulenti Royal Haskoning Nederland B.V, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 546, date 28.05.2009 “Për miratimin e Masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”, me ndryshimet që mund të pasojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

“Mirëmbajtja” ose Mirëmbajtja Parandaluese është përkufizuar si kujdesi nga ana e personelit, dhe servisi për qëllim të mirëmbajtjes së pajisjeve, mjeteve dhe objekteve në kushte operimi të kënaqshme, duke siguruar inspektimin sistematik, zbulimin dhe korrigjimin e defekteve para se ato të ndodhin, ose para se të zhvillohet në defekte të mëdha. Mirëmbajtja përfshin teste, masa, rregullime, dhe pjesë këmbimi, të kryera në mënyrë specifike për të parandaluar defektet para se të ndodhin.

“NVP” – Net Present Value (Vlera Aktuale Neto) është shuma 439,867,260.74 leke që përbëhet nga investimet e Konçesionarit në 10 vitet e para të periudhës së Marrëveshjes. Vlera aktuale neto (NPV) është e llogaritur me një normë zbritjeje prej 10% - të infrastrukturës, superstrukturës, makinerive dhe mjeteve operacionale, sistemeve dhe përmisimeve teknike të ofruara nga Konçesionari për (10) vitet e para



të operacioneve.

"Shërbimet e Projektit" janë shërbimet që do të kryhen nga Konçisionari në përputhje me këtë Kontratë dhe Ankeset e saj.

"Shoqëria Koncesionare" ose **"Operatori"** do të thotë Konçisionari sipas kësaj kontrate.

"Standarte Kualiteti" do të thotë Standartet ISO 9001:2008, ISO 14001, ISO 28000 dhe BS OHSAS 18001, sipas parashikimeve të Dokumentave Tenderit.

"Rasti i Mospërbushjes Mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktor" do të thotë rastet e mospërbushjes të përcaktuara në Nenin 18.1.2.

"Rasti i Mospërbushjes nga Konçisionari" do të thotë rastet e mospërbushjes të përcaktuara në Nenin 18.1.1.

"Taksë" do të thotë çdo taksë, detyrim, tatim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vënë, e kërkuar, ose mbledhur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas Ligjit.

"Tarifë e shërbimeve" do të thotë tarifat për shërbimet në port, të vendosura nga Autoriteti Portual Durrës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

"Terminal i Trageteve dhe Kroçerave"(TTD) do të thotë Terminali Trageteve dhe Kroçerave Durrës i përbërë nga kalatat 8, 9 në zonën veriore sipas Master Planit të Portit të Durrësit, dhe kalata nr. 7 pa zonën pas saj siç është përshkruar në nenin 2 në Aneks 4 të kësaj Kontrate, dhe që do të zhvillohet në përputhje me Master Planin e Portit të Durrësit, trafikun, dhe kërkesat sipas kësaj Kontrate.

"Vlera e Investimit" do të thotë shuma totale në Euro 4 143 000 (katërmilione njëqindëdyzetetremijë) për kryerjen e investimit të nevojshëm sipas Aneks 2 të Kontratës, për realizimin e infrastruktures dhe shërbimeve të Projektit siç përcaktohet në Nenin 8.5 të Kontratës

"Xhiro Vjetore" do të thotë të ardhurat bruto vjetore që grumbullohen nëpërmjet mbledhjes së tarifave të përpunimit të pasagjereve dhe ngarkesave Ro-Ro nga Konçisionari në përputhje me legjislacionin në fuqi, para pagesës së taksave në përputhje me legjislacionin shqiptar, e cila do të shërbejë si bazë për përllogaritjen e tarifës koncesionare.



“**Termet e Referencës (TeR)**” janë pjesë e Aneks 1 të kesaj kontrate dhe permbajne fushën e objektit të veprimtarisë që kërkohet të kryhet nga Konçesionari sipas kësaj Kontrate.

„**Zonë e Koncesionit**“ do të thotë zona ku do të zhvillohet Objekti Konçesionit, në përputhje me nenin 2.2 dhe Ankes 4 të Kontratës.



1.2 Interpretime

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë:

- 1.2.1 Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- 1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjinitë e tjera;
- 1.2.3 Referimi tek personat fizikë do të nënkuptojë edhe referimin tek personat juridikë të çdo lloj forme organizimi në kuptimin më të gjerë të mundshëm si dhe tek çdo lloj forme tjetër organizimi në kuptimin më të gjerë të mundshëm që nuk ka personalitet juridik;
- 1.2.4 Referimi tek një ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë përfshin referimin tek ai Ligj, vendim, rregullore, urdhër apo procedurë siç është/mund të jetë ndryshuar, shtuar apo rimiratuar kohë pas kohe dhe tek çdo akt tjetër i dalë në mbështetje e për zbatim të tyre;
- 1.2.5 Termi "ndërtim" do të përfshijë apo nënkuptojë proceset e investigimit, projektimit, prokurimit, dërgimit, transportit, instalimit, përpunimit, fabrikimit, testimit, komisionimit si dhe procese të tjera të lidhura direkt apo indirekt me ndërtimin;
- 1.2.6 Termat "të kësaj", "këtu", "nëpërmjet kësaj ose nga kjo", "në këtë" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë neni, paragrafi, tabele, Aneksi ose grafiku apo ndonjë nëndarje tjetër të kësaj Kontrate;
- 1.2.7 Parathënia, Anekset dhe dokumentat të kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontratedhe referencat ne Anekset dhe dokumentat, do të jenë referenca në shtojcat, tabelat dhe Anekset e kësaj Kontrate, përveç kur Palët bien dakord ndryshe;
- 1.2.8 Çdo frazë që fillon me fjalët "përfshin" ose "duke përfshirë", "në vecanti", "për shembull", "të tilla si" apo të ngjashme, do të kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- 1.2.9 Referencat ne "këtë Kontratë" ose "kjo Kontratë Konçesioni" do të interpretohen si referenca në këtë Kontratë siç mund të ndryshohet ose modifikohet në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;
- 1.2.10 Sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "ditësh" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur specifikohen si Ditë Pune;
- 1.2.11 Çdo referencë në "muaj" ose "vit" do të interpretohet si referencë në një muaj



kalendarik ose në një vit kalendarik.

- 1.2.12 Cdo fjalë, term, fraze dhe shkurtime që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Aneks, bashkëlidhje a dokument tjetër bashkëngjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Aneks, bashkëlidhje a dokument, sipas rastit;
- 1.2.13 Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
- 1.2.14 Në rast mospërputhjeje midis çdo fjale me gërmë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtime të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjalë me gërme të madhe, termi, fraze ose shkurtime parashikuar gjetkë në këtë Kontrate, Aneks, bashkëlidhje ose në një dokument tjetër bashkëngjitur tek çdo bashkëlidhje, kuptimi i dhënë në Nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo Aneks, bashkëlidhjeje a një dokument tjetër bashkëngjitur çdo bashkëlidhjeje, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;
- 1.2.15 Një referim tek një Ent Shtetëror nënkupton referencën tek juridiksioni i tij dhe nëse ky Ent Shtetëror:
- i) zëvendësohet nga një organ/ent tjetër, atëherë i referohet juridiksionit të këtij të fundit;
 - ii) pushon së ekzistuari, atëherë i referohet juridiksionit të organit/entit, i cili ka kompetenca të përafërta ose të njëjta me organin/Entin Shtetëror që ka pushuar së ekzistuari;
- 1.2.16 Kudo në Kontratë dhe në gjithë dokumentacionin bashkëngjitur asaj, termi "Konçesionar" do të nënkuptojë njëkohësisht edhe termin "Shoqëri Konçesionare" dhe anasjelltas;
- 1.2.17 Pa paragjykim ndaj paragrafëve të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet neneve dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojce të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër të cilit i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë, duke bërë interpretimin me mirëbesim, nisur nga qëllimi që kanë patur Palët:
- i) Kërkesat e Autoritetit Kontraktues (Dokumentat Standarte të Tenderit);
 - ii) Oferta e Konçesionarit;
 - iii) Kontrata Konçesionare, Anekset dhe çdo dokument tjetër bashkëlidhur;



iv) Çdo dokument tjetër ku Kontrata Konçesionare bën referencë;

1.2.18 Gjithashtu gjatë interpretimit të kësaj Kontrate do të mbahen parasysh rregullat me poshtë:

- i) kur ka mospërputhje mes dy neneve të Kontratës do të ketë përparësi neni që rregullon në mënyrë të posaçme çështjen e paqartë apo objekt mosmarrëveshjeje;
- ii) kur ka mospërputhje mes dimensioneve të paraqitura në projekte dhe dizeno me dimensionet e shkruara, keto të fundit do të kenë përparësi;
- iii) kur ka mospërputhje mes vlerave numerike të shprehura në shifra dhe të paraqitura me fjale, këto të fundit do te kenë përparësi;

NENI 2 KONÇESIONI

2.1 Objekti i Konçesionit

- 1 Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me kushtet e saj, i jep Konçesionarit të drejtën për investimin, menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik, dhe adaptimin për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin e Trageteve dhe Kroçerave Durrës (TTD) duke përfshirë imbarkimin dhe disimbarkimin e Anijeve të kombinuara për pasagjerëdhe/ose RoRo (tragete, katamarane etj) dhe të Kroçerave dhe aktivitete përkatëse të lidhura me to si ankorimi i anijeve, lëvizja e udhëtarëve në terminal, orientimi, depozitimi, magazinimi i mjeteve, pozicionimi, transporti, spontimi, marrja dhe shpërndarja dhe përfshirjen e sigurimit e burimeve të nevojshme që janë mjetet dhe pajisjet, sistemet, praktikat procedurat dhe programet, organizimin dhe burimet njerëzore në përputhje me praktikat më të mira industriale siç përcaktohet në TeR.

2.2 Terminali dhe Zonat e Konçesionit

- 1 Zona në të cilën shtrihet ky Konçesion (nga kalatat 8, 9 së bashku me zonat dhe sheshet korresponduese të operacioneve, trafikut dhe të depozitimit përfshirë terminalin e pasagjereve në zonën veriore sipas Master Planit të Portit të Durrësit dhe kalata nr. 7 pa sheshet pas kësaj kalate, dhe gjithashtu zona e parkimit dhe kryerjes se procedurave paraprake pranë hyrjes nr. 4 të Portit të Durrësit) siç përcaktohet sipas vizatimeve dhe hartave bashkëngjitur kësaj Kontrate dhe përcaktimit në Master Planin e Portit te Durrësit.
- 2 Cdo aktivitet i Koncesionarit jashtë kufijve të TTD (është apo jo pjesë e shërbimeve të Konçesionarit) duhet të aprovohet më parë me shkrim nga Autoriteti Portual Durrës.



- 3 Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Portual Durrës, bien dakort që gjatë Periudhës së Koncesionit, Zona e Koncesionit përfshirë Infrastrukturen e TTD dhe instalimet në të, dhe çdo zone tjetër afër terminalit ashtu siç përcaktohen në Aneks 4 të Kontratës, do të merren në dorëzim dhe do të jenë nën dispozicionin e Koncesionarit në gjendjen "siç janë" dhe në kohën e përcaktuar për fillimin e operimit.
- 4 Përkufizime shtesë për zonën e terminalit:
- 4.1 **Zona ekzistuese e terminalit "Back-up area"** është zona ekzistuese ku shtrihet Terminali i Trageteve dhe shënohet me A në Aneks 4 të kontratës:
- a) Zona A është zonë ekzistuese e Terminalit të Trageteve dhe do të jetë gjatë gjithë Periudhës Koncesionare, pjesë e Terminalit dhe Zonës Koncesionare.
 - b) Zona pranë hyrjes nr. 4 të Portit të Durrësit është pjesë e Zonës A dhe është zona e parkimit dhe e kryerjes së procedurave paraprake me anjensite e trageteve dhe do të jetë gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit pjesë e terminalit dhe Zonës Koncesionare.
- 4.2 **Zona e zgjerimit të Terminalit** është zgjerimi i ardhshëm i terminalit në zonën ngjitur dhe shënohet me "B", "C" dhe "D" në Aneks 4 të kontratës.
- a) Zona e zgjerimit të terminalit do të zhvillohet në përputhje me Master Planin e Portit të Durrësit dhe do të jetë pjesë e TTD gjatë gjithë Periudhës Koncesionare. Kjo zonë, do të zhvillohet nga Koncesionari në përputhje me Kontratën Koncesionare.
- 4.3 **Çdo zonë tjetër afër TTD**, është zona në afërsi ose pranë TTD dhe e cila konsiderohet e nevojshme apo kërkohet nga Koncesionari për zgjerimin e aktivitetit apo për kryerjen e operacioneve që kanë lidhje direkte apo indirekte me veprimtarinë e terminalit dhe që i shërbejnë Përdoruesve të Portit.
- 5 Zhvillimi, marrëveshja e qerasë dhe përdorimi i këtyre zonave nga ana e Koncesionarit, do të jetë si më poshtë:
- a) **Zona ekzistuese e Terminalit "Back-up area"**
 - i) Koncesionari ka të drejtë të marrë në dorëzim dhe të përdorë zonën ekzistuese të Terminalit duke filluar nga Data e Fillimit të Operimit.



- ii) Koncesionari do të paguajë tarifën e qerasë së përcaktuar në nenin 8 të kontratës, për zonën ekzistuese të TTD duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të saj.

b) Zona e zgjerimit

- i) Koncesionari është i autorizuar të zhvillojë zonën e përcaktuar për zgjerimin e terminalit për llogari të tij, dhe në përputhje me standartet e aplikuara dhe të përshtatshme për operacione të sigurta në lidhje me pasagjerët dhe magazinimin e ngarkesave dhe/ose mjeteve dhe për procedurën të lidhura me Objektivin e Koncesionit. Ky zgjerim do të bëhet në përputhje me Ofertën e Koncesionarit sipas Aneks 2 të Kontratës, kërkesat e tregut dhe me planin e zhvillimit të Koncesionarit, respektivisht nëse kërkohet nga zhvillimi ose ndryshimi i trafikut dhe sigurimi i hapësirave të nevojshme për depozitim dhe kryerjen e operacioneve.

2.3 Përpunime të tjera

- 1 Në përputhje me këtë Kontratë dhe Ofertën e Koncesionarit sipas Aneks 2, Koncesionari mund të përpunojë anijet turistike, jachte, mjetet e vogla lundruese për pasagjerë.

2.4 Pranimi i Koncesionit

- 1 Koncesionari, nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me parashikimet e saj, pranon Koncesionarin duke rënë dakord e duke marrë përsipër të zbatojë Ofertën e tij për realizimin e investimeve, punëve dhe sigurimin e shërbimeve sipas Aneks 2.
- 2 Koncesionari me shpenzimet, kostot dhe nën përgjegjësinë e tij do të menaxhojë, operojë, mirëmbajë, përmirësojë teknikisht dhe përshtasë TTD, për të përballuar kërkesat aktuale dhe të së ardhmes të parashikuara në Dokumentat e Tenderit dhe Ofertën e tij, në lidhje me trafikun, përfshirë imbarkimin dhe disimbarkimin e Anijeve të kombinuara për pasagjerë dhe/ose RoRo (tragete, katamarane etj) dhe të kroçerave dhe aktivitete përkatëse të lidhura me to si ankorimi i Anijeve, lëvizja e udhëtarëve në terminal, orientimi, depozitimi, magazinimi i mjeteve, pozicionimi, transporti, spontimi, marrja dhe shpërndarja. Koncesionari do të përfshijë dhe sigurojë burimet të nevojshme që janë mjetet dhe pajisjet, sistemet, praktikat procedurat dhe programet, organizimin dhe burimet njerëzore në përputhje me praktikat më të mira industriale siç përcaktohet në TeR në përputhje me Tarifat e Autoritetit Portual Durres për llogari të Anijes, pasagjerëve, mallrave ose mjeteve, në çfarëdo lloj rasti.

Në fund të Periudhës Koncesionare do të transferojë te gjithë infrastrukturen (të



luajtshme dhe të paluajtshme) dhe Shërbimet e projektit tek Autoriteti Kontraktor.

Konçesionari duhet të transferojë infrastrukturen e projektit të Koncesionit në gjendje funksionale pune. Koncesionari duhet, në veçanti, të transferojë të gjithë infrastrukturen e nevojshme të Projektit për një shërbim normal dhe pandërprerje. Nëse pajisje të nevojshme për shërbimin nuk transferohen nga Konçesionari për çfarëdolloj arsyeje (për shembull duke argumentuar që nuk janë në pronësi të tij por janë të marra me qira apo sekuestaruar nga palë të treta etj, atëherë ai detyrohet të derdhe për llogari të Autoritetit Kontraktor kundërvlerën monetare (vlera e re në momentin e transferimit) të kësaj infrastrukture që mungon, dhe Autoriteti Kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar fitimin e munguar.

Koncesionari jep garanci për një periudhë një vjeçare pas datës transferimit për mirëfunksionimin e infrastrukturës. Në përputhje me këtë garanci Konçesionari detyrohet të zëvendësojë çdo pjesë të infrastrukturës (të luajtshme apo të paluajtshme) që nuk është në gjendje pune.

Autoriteti Kontraktues mund të bëjë në çdo kohë një inventar të infrastrukturës (luajtshme apo të paluajtshme) që ndodhet në Zonën e Koncesionit. Ky inventar është i detyrueshëm në vitin e pestë përpara datës së përfundimit të Koncesionit dhe në vitin e fundit përpara datës së përfundimit të Koncesionit. Nëse gjatë inventareve rezultojnë se pajisje esenciale për shfrytëzimin normal të aktiviteteve Objekt të këtij Koncesioni nuk janë në gjendje pune ose janë në Zonën e Koncesionit por janë në pronësi të palëve të treta (psh janë marre me qira nga Koncesionari për tu përdorur në Zonën e Koncesionit) atëherë Autoriteti Kontraktor do t'i rikujtoj me shkrim Konçesionarit detyrimin e tij që në bazë të kësaj Kontrate, duhet të transferojë infrastrukturen e nevojshme për një shërbim normal dhe të pandërprerë.

2.5 Periudha e Koncesionit

- 1 Konçesioni sipas kësaj Kontrate jepet për një periudhë prej 25 (njetzet e pesë) vitesh ("Periudha Konçesionare"), e cila fillon nga Data Efektive. Në rast se Konçesioni shtyhet nga Autoriteti Kontraktues, për shkaqe të parashikuara në këtë Kontratë, tej periudhës në vite të përcaktuar këtu më sipër, Periudha Konçesionare do të përfshijë edhe periudhën shtesë. Në rast se Konçesioni përfundon para periudhës në vite të përcaktuar këtu më sipër, për shkaqe si zgjidhja e Kontratës apo shkaqe të tjera që çojnë në përfundimin e saj, Periudha Konçesionare do të reduktohet/kufizohet në periudhën nga Data Efektive deri në datën e përfundimit të Koncesionit.
- 2 Periudha Konçesionare mund të shtyhet në rastin e Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatuar ngjarja e Forcës Madhore dhe kohën e arsyeshme për riparimin e dëmeve të shkaktuara.



2.6 Deklarime dhe garanci të palëve

2.6.1 Konçensionari dhe Ortakët Themelues të Shoqërisë Koncesionare, deklarojnë dhe garantojnë se:

- a) kanë bërë dhe do të bëjnë, kërkimet dhe studimet e veta për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre të parashikuara në këtë Kontratë dhe se disponojnë të gjithë informacionin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, Dokumentat e Tenderit, dhe çdo lloj informacioni të kërkuar nga Konçensionari para Datës Efektive;
- b) janë në dijeni të plotë përsa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuar në Aneksat e kësaj Kontrate;
- c) zotërojnë të gjithë informacionin, burimet financiare, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshëm, të duhur dhe të kualifikuar me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktore;
- d) do të përmbushin të gjitha detyrimet e rëna dakord, duke shfrytëzuar në menyrë efikase dhe ekonomike, mekanizmat, metodat, procedurat, standardet, dhe normat në përputhje me metodat dhe praktikat profesionale përgjithësisht të zbatuara në portet dhe терминаlet e BE dhe të pranuar si "praktikat më të mira industriale". Koncesionari duhet të ndjeke praktika ekonomike, racionale dhe efektive të biznesit dhe të perdore teknologji të avancuara dhe të pershtatshme si dhe metoda të sigurta.
- e) do të veprojnë gjithmonë si një partner loyal (i besueshëm) i Autoritetit Kontraktor, në pajtim me rregullat, kualitetet dhe standartet si dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe ai do të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- f) në funksion të performancës së shërbimeve profesionale, në TTD, detyrohen të ushtrojnë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta, dhe nuk duhet të marrin pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në perfaqësimin e Autoritetit Kontraktor; Koncesionari nuk mund të përfaqësojë Autoritetin Kontraktues përveç se me një autorizim të qartë nga ky i fundit dhe vetëm për aq sa parashikohet në këtë autorizim.
- g) Në asnjë rast nuk do të kërkojë ndonjë dëmshpërblim, penalitete apo nuk do të ngrejë çfarëdolloj pretendimi/padie në lidhje me zbatimin e Kontratës ndaj Autoritetit Kontraktor apo Enteve Shtetërore të tjera, për fakte, rrethana apo ngjarje të cilat kanë ndodhur ose kanë filluar të ndodhin përpara nënshkrimit të Kontratës;
- h) Në realizimin e Kontratës së Konçesionit, Shoqëria Koncesionare merr pjese së bashku dhe në menyrë solidare me Ortakët themelues, kompanitë FRS Chartering



Beteiligungs-gesellschaft MBH dhe Global Networks Albania. Shoqëria Koncesionare dhe ortakët themelues saj janë solidarisht përgjegjës për të gjitha detyrimet e Konçesionarit që burojnë nga kjo Kontratë.

- i) Nuk ekziston asnjë akt, dokument dhe/ose veprim, i përfunduar, në proces e sipër dhe/ose pezull, para çdo gjykate, gjykate arbitrazhi, organi administrativ apo penal, etj, si dhe nuk ka qënë subjekt i ndonjë gjobe, penaliteti, ndëshkimi, përgjegjësie civile apo penale që kanë ose mund të kenë një efekt i cili mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
- j) Nuk është paguar nga ai apo për llogari të tij asnjë shumë në para apo çfarëdo lloj interesi ndaj çdo funksionari, punonjësi apo përfaqësuesi të Autoritetit Kontraktues për të influencuar ose për t'u përpjekur të influencojë tek ata për lidhjen apo për të përfituar avantazhe në lidhje me këtë Kontratë. Pavaresisht parashikimeve të tjera në kete kontrate, nese pas hyrjes në fuqi të kesaj kontrate rezulton se Konçesionari, ortakët e tij apo persona të lidhur me ta i kanë influencuar apo janë përpjekur për të influencuar funksionaret, punonjesit apo përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktues me ane të parave apo çdo lloj mjete tjeter Autoriteti Kontraktor mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë dhe Konçesionari apo ortakët e tij nuk mund të ngrejë asnjë pretendim për kompensim nga kjo zgjidhje e njëanshme.
- k) Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Konçesionit do të ruajë kontrollin lidhur me menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen në Shoqërinë Konçesionare.
- l) Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonje shkelje të pronësisë intelektuale gjatë zbatimit të Kontratës ose nga përdorimi i sendeve të furnizuara sipas Kontratës, ai do t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Shoqërisë Konçesionare që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim;
- m) të gjitha kontratat që do të lidhen nga Konçesionari me të tretë nuk do të kenë periudhë vlefshmerie më të gjatë se 3 (tre) muaj pas përfundimit të Periudhës Konçesionare. Koncesionari detyrohet që, në çdo kontratë që lidh palët e treta të parashikojë se ajo do të zgjidhen me kërkesë me shkrim të Autoritetit Kontraktor nëse kjo Kontratë Koncesioni përfundon përpara kalimit të periudhës së Konçesionit. Nëse Koncesionari shkel këtë detyrim ai dhe Ortakët e tij përgjigjen solidarisht për dëmet që mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktor.

2.6.2 Shoqëria Konçesionare deklaron dhe garanton se:

- a) është themeluar dhe organizuar në mënyrë të vlefshme në përputhje me Ligjin si dhe gëzon të gjitha tagrat të ushtrijë të drejtat dhe të përmbushë detyrimet sipas kësaj



Kontrate;

- b) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe gëzon të gjitha tagrat dhe kompetencat për të negociuar, lidhur, ekzekutuar dhe përfunduar këtë Kontratë, dhe se kjo e fundit është detyruese, e vlefshme dhe angazhuese kundrejt tij;
- c) do të kryejë shërbimet duke shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe ekonomike, mekanizmat, metodat, procedurat, standardet, dhe normat në përputhje me metodat dhe praktikat profesionale përgjithësisht të zbatuara në portet dhe terminalët e BE dhe të pranuar si "Praktikat më të mira Industriale". Konçesionari duhet të ndjekë praktika ekonomike, racionale dhe efektive të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuara dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- d) do të fillojë operimin brenda 150 ditësh nga Data Efektive. Deri në datën e fillimit të Operimit nga Konçesionari, TTD do të operohet nga APD dhe tarifat e mbledhura do të jenë të ardhura të APD-së;
- e) pas nënshkrimit të Kontratës, Konçesionari duhet të paraqesë për inspektim nga Autoriteti Kontraktor pajisjet dhe mjetet të deklaruara prej tij në Ofertë sipas Aneks 2 si investim për fillimin e aktivitetit (operimit) së bashku me faturat përkatëse që vërtetojnë se ka likuiduar detyrimet përkatëse doganore dhe tatimore në Shqipëri. Ky afat nuk do të kalojë periudhën prej 150 ditësh nga data e firmosjes së Kontratës.
- f) në qoftë se nuk arrin që të paraqesë mjetet dhe pajisjet, e propozuara në këtë konkurim si investim për fillimin e operimit, përpara mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën j) më sipër, Konçesionari duhet të paraqesë një evidencë të dokumentuar që pjesa e mjeteve që nuk është furnizuar akoma, është prokuruar dhe gati për transport në Portin e Durrësit.
- g) Autoriteti Portual Durrës, në bazë të nenit 35.4 të ligjit nr. 9310 /9130/2003 "Për Autoritetin Portual" ka të drejtën që në çdo kohë nëpërmjet marrëveshjes me shkrim me Konçesionarin, të ndryshojë pjesërisht ose tërësisht tarifat e publikuara në përputhje me legjislacionin në fuqi në, momentin e ndryshimit. Pavaresisht nga sa më lart Konçesionari mund të kërkojë rishikimin e tarifave vetëm nëse në mënyrë që struktura dhe vlerat e tarifave të mos ndikojë negativisht, çenojnë aktivitetin e tij në atë masë që ta bëjnë të pamundur në aftësinë e Konçesionarit për operimin eficient dhe kompetitiv të terminalit dhe kjo kërkesë nuk do të refuzohet nga APD pa argumente të arsyeshëm. Në veçanti, do të konsiderohet argument i arsyeshëm fakti që Konçesionari mund të riorganizohet nga ana administrative ose mund të organizojë ndryshe punën e tij në mënyrë që të arrijë të njëjtin rezultat me kosto më të ulët. Po kështu, do të konsiderohet argument i arsyeshëm fakti që Konçesionari mund të investojë në pajisje që i mundësojnë uljen e kostove të tij. Nëse APD pranon të rishikojë tarifat me kërkesë të Konçesionarit ky rishikim nuk mund të shkojë përtej



masës që është e nevojshme për të mos ta bërë të pamundur operimin e terminalit.

- h) Do të blejë nga Autoriteti Portual Durrës, sipas marreveshjes për transferimin dhe blerjen e mjeteve dhe pajisjeve ekzistuese të cilat ndodhen në Terminalin e Trageteve të Portit të Durrësit, të përcaktuara nga APD, të cilat i shërbejnë këtij Konçesioni, sipas Kushteve të përcaktuara në Aneks 6 të Kontratës dhe të respektojë kushtet dhe termat e saj.
- i) Do të komunikojë çdo vit Autoritetit Kontraktues koston për secilin nga shërbimet e tij.

2.6.2 Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Portual Durrës së bashku deklarojnë dhe garantojnë se:

- a) Në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë në rast ndarje, bashkim ose ndryshim portofolësh eventuale sipas ligjeve në fuqi, shprehja "Autoritet Kontraktor", sipas kësaj Kontrate, do t'i referohet Ministrisë përgjegjëse të ngarkuar për drejtimin e politikave të transportit në Republikën e Shqipërisë.
- b) Me marrjen e sigurimit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Konçesionarit informacionin dhe dokumentat të cilat Autoriteti Kontraktor i quan të nevojshme dhe të domosdoshme për Konçesionarin për të performuar shërbimet e rëna dakord dhe për të respektuar obligimet e tij;
- c) Të gjitha të dhënat dhe i gjithë informacioni i vënë në dispozicion janë të sakta, të vërteta dhe pa gabime.
- d) Gëzon të gjitha tagrat në bazë të Ligjit për të lidhur e nënshkruar këtë Kontratë dhe nuk ka fshehur qëllimisht asnjë dokument apo informacion nga Konçesionari dhe është i vetëdijshëm se Oferta e Konçesionarit është përgatitur dhe paraqitur duke u mbështetur në këto informacione dhe/ose dokumenta;
- e) Zotëron gjithë tagrat e nevojshme e të kërkuara nga legjislacioni shqiptar, për nënshkrimin e kësaj Kontrate, të cilat janë dhe do të jenë në force gjatë gjithë vlefshmërisë të kësaj Kontrate, dhe se kjo Kontratë është një detyrim i ligjshëm dhe i zbatueshëm për Autoritetin Kontraktor dhe APD si dhe për çdo person të cilit i kalohen apo trashëgon këtë detyrim.
- f) Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues dhe APD nuk përbën dhe nuk do të përbëjë shkelje apo kundërvajtje me përcaktimet e ligjit shqiptar dhe/ose me kontrata dhe/ose marrëveshje në të cilat Autoriteti Kontraktor dhe/ose APD është/janë Palë.



- g) Asnjë urdhër, urdhër ekzekutimi, urdhër kufizues me karakter administrativ, rregull/rregullore, vendim, pezullim ose sekuestrim nuk do të zbatohet ose urdhërohet të zbatohet nga ndonjë organ administrativ ose Ent Shtetëror që ka juridiksion mbi çeshtjen që kufizon, ndalon ose deklaron të paligjshme aktivitetet e kryera në përputhje me këtë Kontratë.
- h) Ne çdo rast do t'i njohë Konçesionarit te Drejtën e Kalimit në TTD dhe zonat e lidhura me të. Megjithate, kjo e drejte kalimi mund te kufizohet në varësi të interesit publik.
- i) Cdo lloj transferimi i aksioneve/pjesëve të Shoqërisë Konçesionare do të kryhet vetëm në rast se Autoriteti Kontraktor ka dhënë miratimin paraprak;
- j) Konçesionari është i lirë t'u ofrojë klientëve të vet rimbursime ose ulje të normave tarifore të publikuara nga APD, por në çdo rast do të respektojë legjislacionin në fuqi për konkurrencën dhe veçanërisht nuk do të ofrojë asnjë shërbim me çmim më të ulët se kostoja. Në këtë kuadër, Konçesionari detyrohet që çdo vit t'i komunikojë Autoritetit Kontraktor koston për secilin nga shërbimet e tij.
- k) Infrastruktura dhe superstruktura ekzistuese duke përfshirë dhe kalatat është në përputhje me standartet inxhinierike dhe të sigurisë së Praktikës së Industrisë së Mirë Europiane dhe se kalatat janë të qëndrueshme dhe pa rreziqe strukturore.

NENI 3 ANGAZHIME TË PALËVE

3.1 Palët në këtë Kontratë marrin përsipër dhe bien dakord si më poshtë:

3.1.1 Konçesionari merr përsipër dhe bie dakord:

- 1 të nënshkruajë me Autoritetin Portual Durrës, marreveshjen për transferimin dhe blerjen e mjeteve dhe pajisjeve ekzistuese të cilat ndodhen në Terminalin e Trageteve të Portit të Durrësit të përcaktuara nga APD, të cilat i shërbejnë këtij Konçesionari, sipas Kushteve të përcaktuara në Aneks 6 të Kontratës dhe të respektojë kushtet dhe termat e saj.
- 2 t'i japë Autoritetit Kontraktor kopje origjinale (ose të vërtetuara nga noteri) të policave të sigurimit që kërkohen nga kjo Kontratë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga lindja e detyrimit për t'u pajisur me keto polica;
- 3 t'i japë Autoritetit Kontraktor kopje origjinale (ose të vërtetuar nga noteri) të kontratave që do të lidhen mes kompanive themeluese FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft



MBH dhe Global Networks Albania shpk dhe Shoqërisë Konçesionare për realizimin dhe kalimin e përgjegjësive të këtij Konçesioni. Keto kontrata duhet të parashikojnë shprehimisht që Ortakët Themelues të Shoqërisë Konçesionare marrin përsipër dhe janë përgjegjës në mënyrë solidare për çdo detyrim të Shoqërisë Konçesionare sipas Kontratës

- 4 Me përjashtim të pikës a) dhe b), dhe pikave h) dhe i) më poshtë, Konçesionari duhet që, brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh që nga Data Efektive e Kontratës, ti ketë dorëzuar për aprovim Autoritetit Kontraktor dokumentat, rregullat dhe raportet etj. sipas asaj që është përcaktuar më poshtë. Siguria dhe planet e sigurisë sipas pikës a) dhe b) duhet të sigurohet brenda 2 (dy) muajsh, që nga Data Efektive. Plani i biznesit dhe parashikimi i trafikut sipas pikave h) dhe i) janë pjesë e propozimit teknik dhe financiar në Ofertën e Konçesionarit.
- a) Rregulloret e detajuara të Sigurisë Teknike dhe Shëndetësore; ?
 - b) Plan sigurie për fasilitetin e Portit (PFSP);
 - c) Plani operacional; ✓
 - d) Plani i organizimit të burimeve njerëzore; ✓
 - e) Lista e mjeteve dhe pajisjeve; ✓
 - f) Lista e punëve për modernizimin dhe përmisimin teknik të TTD; ?
 - g) Nje program i mirëmbajtjes preventive dhe riparimet; ✓
 - h) Plani i biznesit;
 - i) Parashikimi i trafikut;
 - j) Plani marketing; ✓
 - k) Lista dhe pershkrimi i kompiuterave, hard- dhe software dhe e rrjetit ✓
 - l) Plani i zyrave, ëorkshops, parkingut të makinave dhe makinerive, pajisjeve të punës, shenjat dhe orientuesit e trafikut etj; ✓
 - m) Plani detajuar i mallrave të rrezikshme; ✓
 - n) Plani për pajisjet e sigurisë; ✓
 - o) Plani i mbrotjes nga zjarri; ✓
 - p) Programi i menaxhimit të mbetjeve; ?
 - q) Koncept i detajuar mbi higjenën dhe pastërtinë; ✓



r) Programi per vijëzimet dhe lyerjet dhe plani kohor;

3.1.2. Autoriteti Kontraktues merr përsiper dhe bie dakord:

- 1 Do t'i sigurojë Konçesionarit Lejet, Autorizimet, Liçensat e kërkuara për zbatimin e kësaj Kontrate, që janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktor apo APD, me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për leëshimin e tyre dhe të plotësojë kërkesat ligjore për përfitimin e tyre;
- 2 Do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të asistuar Konçesionarin lidhur me Lejet, Autorizimet, Liçensat e kërkuara per Projektin e Konçesionit, që nuk janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktor apo APD me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për leëshimin e tyre dhe të plotësojë kërkesat ligjore për përfitimin e tyre;

3 Rikonstruksioni i kalatave

- a) Në mënyrë që Konçesionari të kryejë obligimet e operacioneve të tij në mënyrë ekonomike dhe eficiente dhe për shkak të zhvillimit të parashikuar të trafikut të mallrave te cilat kalojnë nëpërmjet Portit të Durrësit, Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Portual Durres pranojnë që kalata nr. 7 pa zonën pas saj dhe kalata nr 8 duke përfshirë edhe zonën e bashkëngjitur të përpunimit, do të rindërtohet/rehabilitohen për llogari të Autoritetit Portual siç është përcaktuar në Master Planin e miratuar të Portit të Durrësit. Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoriteti Portual me tej bien dakord që projekti i rindërtimit/rehabilitimit të kalates nr. 7 dhe 8 do të jete në përputhje me kërkesat e projektimit nga Autoriteti Portual.
- b) Gjithashtu nga Autoriteti Portual Durres është duke u hartuar projekti i Kalates se re 9c si dhe realizimi i pontilit 140 x 15 m, ne mes te kalates 9b dhe atij 9c (qe do të ndërtohet), për akostimin e Trageteve nga të dyja anët. Kalata do të ketë për qëllim përpunimin e trageteve në TTD.
- c) Në qoftë se, per çfarëdo arsye, financimi i ketyre projekteve nuk eshte e mundur të realizohen nga APD, atehere këto projekte do të rindërtohen/ sic rekomandohet në Master Planin e miratuar, për llogari te MPPT në kushte të ngjashme siç përcaktohet ne pikën b) më lart.
- d) Në qoftë se, për çfarëdo arsye, MPPT, gjithashtu nuk është në një pozicion për të filluar, financuar dhe zbatuar projektin rindertimin/rehabilitimin e kërkuar siç është përcaktuar ne pikën a), b) dhe c) më sipër, atëherë MPPT dhe/ose APD ka të drejtë të kërkojë Koncesionarit të marrë përsipër kryerjen e projektit sipas pikës a).



Koncesionari do të fillojë zbatimin e projektit jo më vonë se 18 muaj pas kërkesës me shkrim të Autoritetit Portual (për çdo projekt) me kusht që Koncesionari të pranojë dhe është në gjendje të sigurojë në kohë të ardhurat e nevojshme financiare (kredi bankare).

- e) Para fillimit të punimeve të rindërtimit sipas pikes a) më lart dhe me kusht që Koncesionari të pranojë e të jetë i suksesshëm në sigurimin e fondeve të nevojshme financiare (kredi) për kryerjen e projekteve Autoritetit Portual Durrës dhe Koncesionari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të përfundojnë një marrëveshje që rregullon zbatimin e projektit/ëve në kushte reciprokisht të rëna dakord. Këto kushte duhet të përfshijnë, inter alia, kushtet e mëposhtme:
- i) Përcaktimi i fondit limit dhe afat i projektit;
 - ii) Dëshmi që Koncesionari ka siguruar financimin e projektit;
 - iii) Nevoja për kontraktimin e një konsulti inxhinierik kompetent dhe të kualifikuar për dizejnimin, dokumentat e tenderit, zbatimin dhe kontrollin teknik dhe financiar të projektit duke përfshirë procedurat e miratimit për të ruajtur interesat e APD për cilësinë e projektit;
 - iv) Nevoja për monitorimin e projektit nëbermjet stafit të APD;
 - v) Nevojat për aplikimin e normave dhe standarteve ndërkombëtare të pranuar;
 - vi) Nevoja për zbatimin e projektit sipas Ligjit Shqiptar;
 - vii) Nevoja për procedurat e rimbursimit që garantojnë kompensimin e shpenzimeve të Koncesionarit në një mënyrë të përshtatshme, në përputhje me marrëveshjen e kredisë, nga detyrimet e pagesave të Koncesionarit kundrejt MPPT/APD;
 - viii) Nevoja për të garantuar Koncesionarin për kompensimin e shpenzimeve të tij në rast se marrëveshja për Koncesion ndërprietet ose zgjidhet gjatë Periudhës së Koncesionit;
 - ix) Nevoja për procedurat për forcë madhore dhe arbitrazh;

ENI 4 SIGURIMI I KONTRATËS

- 1 Koncesionari, me qëllim përmbushjen e detyrimeve gjatë ekzekutimit të Kontratës, do t'i ofrojë Autoritetit Kontraktor një Sigurim Kontrate të parevokueshem dhe të pagueshem me kërkesën e parë, në formën e një police sigurimi të pakushtëzuar të leshuar nga shoqëri sigurimi shqiptare ose në formën e një garancie bankare në shumën Euro 414 300 (katërqindkatëmbëdhjetëmijë e treqind) që i korrespondon



10 (dhjete) % te Vlerës së Investimit.

Dorëzimi i Sigurimit së Kontratës (Garancisë së Performancës) duhet të jete në formën e pranueshme siç specifikohet në ANEKS VII – 5: FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATES të DT.

- 2 Koncesionari është i detyruar, që gjatë Periudhës së Koncesionit, të zëvendësoj menjehere në Sigurimin e Kontratës shumën të cilen Autoriteti Kontraktor i ka zbritur nga Sigurimi i Kontratës. Dështimi i Koncesionarit në mbushjen (plotësimin e shumës së zbritur) menjëherë pas një njoftimi me shkrim nga Autoriteti Kontraktor të sigurimit te kontrates, me shumën e zbritur, mund të rezultojë në veprime ndëshkuese nga Autoriteti Kontraktor. Për të shmangur dyshimet termi “menjherë” nuk do të kaloje një periudhe prej tre 3 (tre) javësh.
- 3 Sigurimi i Kontratës duhet të jetë në fuqi deri në 90 ditë pas datës së përfundimit të Kontratës.
- 4 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktor nuk pajtohet me punën, shërbimet ose performancën e Koncesionarit sipas Marrëveshjes, Sigurimi i Kontratës do ti dorëzohet Koncesionarit pas plotësimit të suksesshëm të shërbimeve të Koncesionarit ne fund te Periudhës së Koncesionit. Me kusht qe shërbimet të dorezohen me sukses, dorezimi i Sigurimit të Kontratës do të kryhet brenda 90 ditëve nga data e përfundimit të Kontratës në shkëmbim të një njoftimi përfundimi.

NENI 5 PRONËSIA INTELEKTUALE

- 1 Autoriteti Kontraktor dhe APD garantojnë Koncesionarin se kanë të gjitha të drejtat e pronësise intelektuale (nëse eshte rasti) përfshire liçencat e duhura që kanë të bejnë në hardëare-t dhe programet kompjuterike (softëares) që do të përdoren gjatë zbatimi i këtij Konçesioni, deri në Datën Efektive.
- 2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Konçesionari gjatë Kontratës, perveç atyre që i perkasin ekskluzivisht Konçesionarit, do t'i perkasin Autoritetit Kontraktor, i cili mund t'i perdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Konçesionari, pas përfundimit ë kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Konçesionari gjatë Kontratës. Konçesionari mund të mbajë kopje të ketyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që nuk kanë lidhje me Kontratën, perveçse kur pajiset me leje paraprake me shkrim nga Autoriteti



Kontraktor. Mos respektimi i ketyre kushteve është një arsye për Autoritetin Kontraktor për mos kthimin e sigurimit të Kontratës dhe për mos lëshimin e letrës së konfirmimit të perfundimit.

- 4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Konçesionari duhet t'i japë Autoriteti Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Konçesionarit që kane të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

NENI 6 NJËSIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT DHE PËRFAQESIMI I PALËVE

- 1 Brenda 10 (dhjete) ditësh nga Data Efektive, me urdher të Ministrit të MPPT krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit Konçesionar ("NjZP") pranë MPPT. Përberja dhe përgjegjësia e NjZP do të përcaktohen në Urdhërin e Ministrit. Ky urdhër nuk do të përmbajë detyrime kontraktore shtesë ndaj Konçesionarit. Puna e NjZP do të vazhdojë gjatë gjithë Periudhës Konçesionare.
- 2 Kompetencat dhe detyrimet e NjZP nuk do të kalojnë kompetencat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor apo Autoriteti Portual Durrës, siç përcaktohet në Kontratën e Konçesionit.
- 3 Më tej, ajo është rënë dakord dhe kuptohet se NjZP nuk do të ndërhyjë në mënyrën dhe metodat e Konçesionarit për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e TTD, por duhet, aty ku është e nevojshme, të masë performancën e Konçesionarit vetëm me anë e përdorimit të indikatorëve të performancës të pranuar reciprokisht.
- 4 Çdo Palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqesimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.
- 5 Secila palë duhet të lajmerojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emerimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmerojë, duhet të marrë përsiper çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshem.
- 6 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar |Palën në veprime ose veprimtari të veçanta, Në çdo rast duhet dhënë njoftimi me shkrim dhe duhet të përcaktohet shtrirja e autoritetit të përfaqësuesit.



NENI 7 DATA EFEKTIVE

- 1 Data Efektive e kësaj Kontrate do të jetë data e nënshkrimit të saj nga Palët.

NENI 8 ÇESHTJE FINANCIARE DHE TË PAGESËS

8.1 Vlera e Kontratës së Konçesionit

- 1 Vlera totale vjetore e kësaj kontrate përfaqëson shumën totale vjetore të përcaktuar në Seksionin 6 pika 6.4 "Llogaritja e çmimit dhe vlera e Kontratës" të Dokumentave të Tenderit).
- 2 Vlera totale vjetore e kësaj kontrate është pjesërisht e fiksuar nga Autoriteti Kontraktor dhe APD, dhe pjesërisht e ofruar nga Konçesionari në Ofertën e tij financiare pjesë e kësaj Kontrate.

8.2 Vlera e të ardhurave të Konçesionarit

- 1 Sipas kësaj Kontrate Konçesioni, pagesa e Konçesionarit përlogaritet nga pjesa/përqindja e të ardhurave të Konçesionarit të mbledhura nëpërmjet Tarifave të shërbimeve nga operimi për përpunimin e anijeve, mjeteve dhe përpunimin e ngarkesave dhe shërbimeve të tjera të lidhura, (si. p.sh. përpunimi në Anije) për çdo vit të kohëzgjatjes së Kontratës, e bazuar nga kategoritë e Tarifave siç përcaktohet në pikën 8.2.4 të këtij neni, sipas kësaj Kontrate e cila do të publikohet nga APD kohë pas kohe në Tarifat e saj.
- 2 Vlera e pagesës përfaqëson shumën që Konçesionari do të mbajë si pjesën e tij të të ardhurave nga Tarifat në ngarkim të Përdoruesve të terminalit, në çdo vit të kësaj marrëveshje, për ofrimin e Shërbimeve ndaj Përdoruesve të TTD, pasagjerëve, pronarëve të mallrave, të anijeve ose automjeteve ose për Shërbime të tjera sic përcaktohen në pikën 8.2.4 të këtij neni.
- 3 Konçesionari do të organizojë financimin e investimeve të kërkuara dhe të rëna dakord për kryerjen e operacioneve dhe të mbajë të gjitha kostot për përmirësimin teknik të infrastrukturës të terminalit, të sigurojë mjetet makineritë, dhe paisjet shtesë, sistemet kompjuterike, fuqinë punëtore dhe të përgjigjet për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte që lidhen me detyrimet për të ofruar shërbimet në TTD dhe këtu përfshihet, ndër të tjera, të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin, siguria, energjia, karburanti, elektriciteti, uji, komunikim, siguri etj.
- 4 Kategoritë e mëposhtme të tarifave të shërbimeve janë baza e llogaritjes të pjesës së



të ardhurave të Konçesionarit për operimin e Anijeve, pasagjerëve, mjeteve, infrastrukturës dhe për kryerjen e shërbimeve ekstra.

- a) Tarifat e Shërbimeve të lidhura me tragetet përfshijnë:
 - i) Përpunimin e pasagjereve, përfshire imbarkimin /disimbarkimin e mjeteve dhe bagazheve të tyre dhe shërbimet shoqëruese sipas kategorive siç përcaktohen në Tarifat e APD;
 - ii) Operacionet me tragetet duke përfshirë imbarkimin/disimbarkimin dhe spontimin, lëvizjet, lidhjet zgjidhjet, magazimin e mjeteve dhe ngarkesave dhe mjeteve të ngjashme – p.sh trailera – sipas kategorisë së mjeteve dhe punëve të percaktuara në Tarifat e APD;
 - iii) Çdo tarifë tjetër e zbatueshme për Shërbimet (ekstra) të tjera siç kërkohet nga pronari apo komanda e anijes per kategori pune siç ose është përcaktuar në Tarifat e APD.
- b) Tarifat e shërbimeve të lidhura me ngarkesat përfshirë:
 - i) Marrja dhe dorëzimi i pasagjerëve dhe mjeteve si dhe mallra të tjera per kategori pune siç përcaktohet ne Tarifat e APD;
 - ii) Depozitimi tranzit i ngarkesave ose mjeteve në sheshe sipas kategorisë së punës të paraqitura në librin e Tarifave të APD-se;
 - iii) Dhenia me qera e makinerive të Konçesionarit;
 - iv) Çdo tarifë tjetër për shërbime (ekstra) shtesë të ofruar nga Konçesionari dhe pranuar nga Përdoruesit e terminalit sipas kategorisë së punës të percaktuara në librin Tarifave të APD;
 - v) Tarifat e sigurise Portuale.

8.3 Pagesa e Konçesionit

- 1 Konçesionari do të paguajë për Autoritetin Kontraktor i) Fee Konçesionare dhe për APD ii) Royalty (I) ,iii) Royalty (II) dhe iv) Tarifën e qerasë (Leasing fee) sipas propozimit financiar të ofruar nga Konçesionari ne Ofertën e tij si vijon:

Lloji i pagesës	Shuma	Afati dhe mënyra e pagesës
i) Fee Konçesionare (e fiksuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit)	Ne vleren 2% (dy përqind) të të ardhurave totale bruto të Konçesionarit.	Konçesionari detyrohet t'i paguajë Autoritetit Kontraktor një Tarifë Konçesionari të barabartë me 2% të xhiros



vjetore (para tatim fitimit) që Konçesionari do të grumbullojë nga Tarifat e shërbimeve që do të kryejë gjatë operimit në TTD (duke përjashtuar TVSH-në), bazuar në deklaratimet financiare të kontrolluara të Shoqërisë Konçesionare për çdo vit financiar. Detyrimi i Konçesionarit për pagesën e Tarifës Konçesionare, fillon nga Data e Fillimit të Operimit dhe paguhet çdo muaj brenda datës 15 të muajit për muajin e mëparshëm.

- ii) Royalty (I) 49 % (dyzetënetë) e Pagesa do të jetë mujore në fillim të çdo muaji për muajin e mëparshëm dhe afati për pagesë do të jetë brenda datës 15 të muajit për muajin e mëparshëm
- (Një pjesë në përqindje si Royalty fiksuar nga Autoriteti Portual Durrës për të gjitha shërbimet që do të tarifohen sipas Tarifave të aplikueshme të Autoritetit Portual Durrës për shërbimet dhe operacionet e ndryshme për Tragetet, Kroceret, pasagjeret, mallrat, makinat, mjetet ose Shërbime ekstra të ofruara nga operatori, për tu paguar në fillim të çdo muaji për muajin e mëparshëm nga Operatori për Autoritetin Portual Durrës në vlerën me përqindje)*
- iii) Royalty (II) Sipas Ofertës së Konçesionarit 1 % (një përqind) Pagesa do të jetë mujore në fillim të çdo muaji për muajin e mëparshëm dhe afati për pagesë do të jetë brenda datës 15 të muajit për muajin e mëparshëm
- Një ndarje shtesë në përqindje, e fiksuar shtesë si Royalty, e ofruar nga Konçesionari për Autoritetin Portual Durrës për të gjitha*



shërbimet që do të tarifohen sipas Tarifave të aplikueshme të Autoritetit Portual Durrës për shërbimet dhe operacionet e ndryshme për tragetet, kroceret, pasagjerët, mallrat, makinat, mjetet ose Shërbime ekstra të ofruara nga Konçesionari, për tu paguar në fillim të çdo muaji për muajin e mëparshëm nga Konçesionari për Autoritetin Portual Durrës në vlerën me perqindje:

- iv) Terminal Leasing Fee 544 (Nje fee qeraje e Terminalit Te Trageteve e fiksuar nga APD për tu paguar në bazë vjetore nga Konçesionari Autoritetit Portual Durrës) (peseqindedyzetekater) leke/m²/vit Pagesa do të jetë mujore në fillim të çdo muaji për muajin e mëparshëm dhe afati për pagese do të jete brenda datës 15 të muajit për muajin e mëparshëm
- v) Pagesa të tjera Sipas një marrëveshje te veçantë
- 2 Është rënë dakort ndërmjet Palëve, se detyrimet e Konçesionarit për pagesë ndaj Autoritetit Kontraktor të Tarifës së Konçesionit do të bazohen në përqindjen e Xhiros Vjetore dhe për APD Royalty (I) dhe (II) do të bazohen në përqindjen e Tarifave të shërbimeve, ashtu siç janë përcaktuar në pikën 8.3.1 më sipër.
- 3 Pas një periudhe një javore gratis (grace period) nga data e përcaktuar për pagesën sipas pikës 8.3.1 më sipër, çdo pagesë e pakryer (e prapambetur) e pagesave të Konçesionit që rrjedhin nga kjo Kontratë, do të paguhet së bashku me një interes prej 0.03% për çdo ditë vonesë, e llogaritur kjo mbi tarifën e papaguar (e prapambetura). Në rast se Konçesionari do të jetë në vonesë mbi 3 (tre) muaj, Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtë të mbajë pagesat për tarifën e prapambetura plus interesat përkatëse nga shuma e Sigurimit të Kontratës.
- 4 Konçesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor dhe/ose Autoritetit Portual Durrës, sipas rastit, pa njoftim të mëtejshëm në datat e rëna dakord, duke përdorur një mënyrë pagese të miratuar nga të dyja palët, bashkë me evidenca dhe dokumenta mbështetëse për çdo pagesë. Konçesionari duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me dokumentacionin që pershkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet



paguar.

- 5 Data e pagesës do të jetë data e transferimit të pagesës në llogarinë e Autoritetit Kontraktor dhe/ose Autoritetit Portual Durrës.
- 6 Konçesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor kopjen e SWIFT-it të pagesës nëpërmjet të cilit është kryer kjo pagesë. Konçesionari nuk do të jetë përgjegjës për vonesat e shkaktuara nga banka. Pagesa duhet të kryhet në monedhën shqiptare ose në euro, përveçse kur është rënë dakord ndryshe, paraprakisht dhe me shkrim mes Palëve. Nëse do të lindë nevoja për referim tek kursi i këmbimit, si kurs këmbimi i monedhave të ndryshme, do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën e pagesës.
- 7 Me mbylljen e vitit financiar dhe çertifikimin e bilancit, Palët do të kryejnë rakordimet lidhur me pagesat konçesionare sipas pikes 8.3.4 më lart. Mosmarrëveshjet lidhur me rakordimet deri në vlerën 20.000.000 lekë nuk do të përbëjnë shkak për mos kryerjen e pagesave pasardhëse

8.4 Mbledhja e te ardhurave nga Konçesionari

- 1 Konçesionari duhet të faturojë dhe mbledhë të ardhurat e tij nga pronari i anijes, ngarkesës ose mjetit ose palëve të interesuara dhe/ose perfaqësuesit e tyre (psh Agjensite), në përputhje me Tarifat e APD dhe me Ligjet financiare në fuqi në Shqipëri.
- 2 Konçesionari do të transferojë pagesën, vjetore dhe/ose mujore Autoritetit Kontraktor dhe/ose Autoritetit Portual, të Tarifave, pagesave dhe detyrimeve, të mbledhura në emër të Autoritetit Portual, nëse ka, dhe për Tarifën e Konçesionit dhe të qerave dhe pjesën e normave të Tarifave të APD-se sic specifikohet në marrëveshjet e veçanta të qerave.
- 3 Konçesionari, nëpërmjet administrimit të tij, duhet të lëshojë faturat për të ardhurat e tij për shërbimet e ofruara (per të dyja, pjesën e tarifave të Konçesionarit dhe pjesën e Tarifave të APD-së) në përputhje me Tarifat e publikuara nga APD-se dhe të bëjë përkujdesjet e nevojshme për të mbledhur pagesat e shërbimeve të tjera nga palët e interesuara.
- 4 Konçesionarit mund t'i kërkohet dhe ai do të pranojë, për arsye thjeshtësimi dhe praktikiteti, të mbledhë tarifa dhe pagesa nga pronarët e anijes, ngarkesës ose makinave transportuese (trailer), përveç detyrimeve dhe pagesave të treguara më lart, në emër të Autoritetit Portual dhe sipas një marrëveshje të veçante që mund të lidhet për këtë qëllim. Për Tarifat të cilat mbledhen nga Konçesionari dhe paguhen 100 % për APD, Konçesionari do të përjashtohet nga pagesa e Tarifës së Konçesionit dhe pagesa e Royalty I dhe II.



- 5 Konçesionari është i lirë dhe rezervon të drejten të bëjë skontime ose zbritje në pjesën e tij të tarifave dhe normave, për punën siç tregohet në pikën 8.2.4 të këtij neni. Kryerja e zbritjeve ose skontimeve të tilla nuk do të përbëjë kushtin për "price dumping", perkufizuar si një çmim i cili është më poshtë kostos së tij.
- 6 Konçesionari është i vetedijshëm, dhe me anën e kësaj e pranon, që ai nuk do të imponojë ose kërkojë pagesa, tarifa, taksa apo pagesa të tjera të ndryshme që janë e ardhur ekskluzive e Autoritetit Portual me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe. Në rast dyshimi, Konçesionari do të konsultojë Autoritetin Portual përpara se të llogarisë ose imponojë pagesa të tilla dhe vendimi i Autoritetit Portual në çdo rast është i detyrueshëm.

8.5 Tarifat e Shërbimit

- 1 Shoqëria Konçesionare (Operatori) do të aplikojë Tarifat e Shërbimit siç percaktohet në Aneks 5 bashkëngjitur kësaj Kontrate duke filluar nga Data e Fillimit të Operimit.
- 2 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë Konçesionari gjithashtu pranon se APD mundet, në çdo kohë, të ndryshojë pjesërisht ose tërësisht, Tarifat e publikuara në përputhje me legjislacionin mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Autoritetit Portual Durrës dhe Konçesionari do të pranojë çdo rregullim në rritje por ka të drejtë të mos pranojë në qoftë se rregullimet kanë ndikim negativ në ekonominë e investimeve të Konçesionarit.
- 3 Çdo rregullim i tillë nuk do të ndikojë në masën e ndarjes në përqindje të detyrimeve të Konçesionarit në pagesat për Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetin Portual Durrës sipas nenit 8.3.1 më sipër.
- 4 Tarifat e Shërbimit do të indeksohen, çdo 5 (pesë) vjet bazuar në Normën e Inflacionit.
- 5 Konçesionari ka të drejtë t'i kërkojë Autoritetit Kontraktor bisedime në lidhje me ndryshimin e Tarifave të shërbimit.

8.6 Vlera e Investimit

- 1 Vlera që Konçesionari do të investojë në këtë Konçesion është 4 143 000 Euro (katërmilionenjëqindëzetetremijë), në përputhje me Ofertën sipas Aneks 2 të Kontratës.
- 2 Net Present Value (Vlera Aktuale Neto) është shuma 439,867,260.74leke që përbëhet nga investimet e Konçesionarit në 10 vitet e para të periudhes së



Marrëveshjes. Vlera aktuale neto (NPV) është e llogaritur me një normë zbritjeje prej 10% - të infrastrukturës, superstrukturës, makinerive dhe mjeteve operacionale, sistemeve dhe përmisimeve teknike të ofruara nga Konçesionari për (10) vitet e para të operacioneve.

8.7 Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve

- 1 Në rast se secila nga Palët do të kërkojë rishikim të kostove dhe shpenzimeve të Konçesionit, duhet të njoftojë Palën tjetër me shkrim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni për një rritje të tillë duke respektuar Proçedurën e Ndryshimeve të Kontratës, sipas nenit 21.4.3 të Kontratës. Palët brenda 5 (pesë) ditëve pas njoftimit do të takohen dhe do të diskutojnë mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve dhe reflektimin që kanë mbi Tarifat e Shërbimit.
- 2 Duke qenë se efienca e xhiros së planifikuar në terminal, mbi të cilën bazohet dhe Tarifa Koncesionare dhe pagesa e Koncesionit, mund të ndikohet thelbësisht nga faktorë ekonomike të brendshëm dhe të jashtëm dhe nga fenomene rajonale, këto do të jenë objekt rishikimi bazuar në kushtet ekzistuese dhe zhvillimin e këtyre kushteve përtej kontrollit të Konçesionarit.
- 3 Me qëllim shmangien e çdo paqartësie paragafi më sipër i këtij neni nuk do të interpretohet sikur lind ndonjë detyrim për Autoritetin Kontraktor dhe APD që të pranojë ndryshimet e kontratës për qëllimet e mësipërme.

8.8 Financimi i Konçesionit

- 1 Financimi i Konçesionit do të kryhet nga Konçesionari sipas Ofertës së Koncesionarit me burimet e veta dhe/ose me burime të siguruara mënyrë të ndryshme financimi ose nga Institucione Financiare.

NENI 9 SHOQËRIA KONÇESIONARE

- 1 Shoqëria Konçesionare është themeluar duke pasur si ortak themeluesit FRS Chartering Betelligungsgesellschaft MBH dhe Global Netëorks Albania sh.p.k, të cilët kanë pranuar përgjegjesine e Ofertës dhe Konçesionit sipas Aneks 9 të Kontratës. Gjatë gjithë Periudhës Konçesionare, Konçesionari dhe Ortakët Themelues do të jenë debitorë solidare në zbatimin dhe përmbushjen e kushteve të Kontratës së Konçesionit.
- 2 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë Konçesionare do të kufizohet në zbatimin e kësaj Kontrate Konçesionari si dhe në çdo aktivitet tjetër ndihmës në funksion të zbatimit dhe



përbushjes së kushteve të kësaj Kontrate Konçesioni.

NENI 10 NËNKONTRAKTIMI DHE TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

10.1 Nënkontraktimi

- 1 Konçesionari mund të nënkontraktojë një ose disa prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, por gjithsesi jo më shumë se 20 % të tyre në total, pas lidhjes së një kontrate të shkruar për këtë qëllim dhe pas miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktor. Miratimi ose refuzimi do të jepet brenda 10 (dhjetë) diteëve nga dita e vënies në dijeni nga Konçesionari. Ky miratim nuk do të refuzohet apo vonohet pa shkaqe të arsyeshme. Në rast se, Autoriteti Kontraktor nuk kthen përgjigje brenda afatit të sipërshtuar, Konçesionari duhet t'i ridrejtohet me shkrim dhe nëse përsëri Autoriteti Kontraktor nuk i kthen përgjigje Konçesionarit, atëherë Nënkontraktori do të konsiderohet i miratuar.
- 2 Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi, nuk do të konsiderohen nënkontraktorë sipas kësaj Kontrate furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave dhe/ose çdo Ofertues i shërbimeve apo punëve të çfarëdo lloji (si punët civile, inxhinierike, projekte, IT, shërbime ndihmese etj.) që nuk kanë lidhje direkte me shërbimet për Anijet dhe ngarkesat, pasagjeret, mjetet dhe shërbimet extra.
- 3 Panvarësisht performancës së nënkontraktorit, aftësisë apo angazhimit të tij, Konçesionari do të jetë plotësisht përgjegjës për zbatimin e Kontratës dhe performancën e detyrave dhe obligimeve të tij.
- 4 Konçesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktor për Nën-Kontraktorët me informacionin e mëposhtëm:
 - i) Emrin, eksperiencën dhe adresën;
 - ii) Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar.
- 5 Për qëllime të nënkontraktimit, Konçesionari mund të angazhojë çdo person që posedon aftësitë e nevojshme, njohuritë speciale dhe aftësitë për ndërtim, inxhinieri, prokurim dhe ndërtim civil/mekanik, inxhinieri elektrike, apo të çdo fushe tjetër që ka lidhje me Projektin apo me menaxhimin, shfrytëzimin optimal dhe mirëmbajtjen e infrastruktures dhe Shërbimeve të Projektit. Gjithsesi, Konçesionari do të jete i vetmi përgjegjës para Autoritetit Kontraktor për të gjitha dëmet, mospërbushjet dhe veprimet a mosveprimet jo në përputhje me këtë Kontratë apo të mangëta të nënkontraktorëve të tij, dhe çdo kontratë që të jetë e pranueshme për Projektin duhet të



jetë në përputhje dokumentat dhe bazën tekniko-ligjore të Projektit.

10.2 Transferimi i të drejtave

- 1 Konçesionari nuk do të transferojë të drejtat, dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate në favor të ndonjë personi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor.
- 2 Gjatë Periudhës së Koncesionit, ortakët e Shoqërisë Koncesionare mund të transferojnë një pjesë të aksioneve ose të gjitha aksionet e shoqërisë tek të tretët me një aprovim paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

NENI 11 SIGURIMI

11.1 Kërkesat për sigurimin

- 1 Konçesionari duhet të sigurojë dhe mbajë të vlefshëm një sigurim të detyrueshem profesional në përputhje me rregullat dhe praktikat e përgjithshme të pranuar, që permbajnë detyrimet e këtij Koncesioni në mënyrë që të zhdëmtoje Autoritetin Kontraktor (Autoriteti Kontraktor të emrohet në këtë siguracion si përfitues) dhe Autoritetin Portual Durres (APD) nga dëmet, humbjet e shkaktuara ndaj personelit të Autoritetit Kontraktor dhe/ose APD ose të pronës nga pakujdesia, dështimet, gabimet ose ndonjë mangësi tjetër gjatë ushtrimit të veprimtarisë, detyrimeve ose shërbimeve të Konçesionarit.
- 2 Me fillimin e operimit, Konçesionari duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjesisë profesionale.
- 3 Konçesionari, pas fillimit të operimit, duhet të sigurojë dhe mbajë të vlefshëm një sigurim të tretë të detyrueshem në përputhje me rregullat dhe praktikat e përgjithshme të pranuar që përmbajnë detyrimet e këtij Koncesioni në mënyrë që të zhdëmtoje ndonjë person të tretë ose ndonjë pronë duke përfshirë Anijet dhe ngarkesat nga dëmtimet e shkaktuara ndaj personit ose të pronës nga pakujdesia, dështimet, gabimet ose ndonjë mangësi tjetër gjatë ushtrimit të veprimtarisë, detyrimeve ose shërbimeve të Konçesionarit.
- 4 Dështimi nga Konçesionari për sigurimin në kohë të sigurimit profesional të kërkuar lejon Autoritetin Kontraktor të kryejë (blejë) një siguracion të tilla në llogari të Konçesionarit dhe të ketë Autoritetin Kontraktor dhe APD të përfshire në këtë sigurim si përfitues.



- 5 Konçesionari do të jetë përgjegjes i vetëm ndaj të gjitha dëmtimeve që mund t'u shkaktohen të tretëve si rezultat i veprimeve të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes sipas kësaj Kontrate, përveç përgjegjësisë që rrjedh nga struktura ndërtimore e dorëzuar jo në përputhje me dokumentacionin teknik të APD dhe për të cilat Konçesionari ka paraqitur rezervat e tij me shkrim.

11.2 Prova e mbulimit me sigurim

- 1 Konçesionari duhet t'i vërë në dispozicion Autoritetit Kontraktor kopje të policave të sigurimit të cilat Konçesionari është i detyruar të zotërojë në përputhje me këtë Kontratë.

11.3 Vlefshmëria e mbulimit me sigurim

- 1 Konçesionari duhet të paguajë primet e sigurimit të policave të detyrueshme sipas kësaj Kontrate gjatë gjithë Periudhës së Konçesionit dhe t'i vërë në dispozicion Autoritetit Kontraktor kopje të policave të sigurimit. Çdo policë siguri duhet të parashikojë që nuk përfundon ose anulohet më heret se 10 (dhjetë) ditë nga dita kur një perfundim apo anullim i tillë i është njoftuar Autoritetit Kontraktues me shkrim. Nëse Konçesionari, gjatë Periudhës së Konçesionit, dështon të paguajë primet e sigurimit të policave të sigurimit të përcaktuara në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i paguajë vetë të gjitha sigurimet për të pasur një policë siguri të vlefshme dhe këto shuma ka të drejtë t'i mbajë nga Sigurimi i Kontratës.

11.4 Bashkëpërfituesi në siguracione

- 1 Autoriteti Kontraktor do të figurojë gjithmonë si bashkëpërfitues i siguracioneve në policat e sigurimit që do të lëshohen. Në rast se Autoriteti Kontraktor/APD nuk figuron si bashkëpërfitues në çdo policë siguri të lëshuar sipas këtij neni, Konçesionari do të konsiderohet se nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate për të ofruar polica siguri të vlefshme në përputhje me Kontratën.

11.5 Moskryerja apo mosrinovimi i siguracionit

- 1 Konçesionari detyrohet të sigurojë, të rinovojë apo të mbajë të vlefshëm apo në fuqi çdo siguracion sipas këtij neni gjatë gjithë Periudhës së Konçesionit. Në të kundërt, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë kryesisht të pajiset me policat e sigurimit që mungojnë apo nuk janë të vlefshme apo në fuqi në një moment të caktuar, duke mbajtur primin/primet përkatëse për siguracionet në fjalë nga Sigurimi i Kontratës.



NENI 12 SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBATJA E KONÇESIONIT

12.1 Detyrimet e Konçesionarit

12.1.1 Menaxhimi dhe shfrytëzimi

Krahas detyrimeve të tjera në këtë Kontratë, Konçesionari do të administrojë dhe, shfrytëzojë, krejtësisht me shpenzimet, kostot dhe nën përgjegjesinë e vet asetet e luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate. Detyrimet e Konçesionarit do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen, si më poshtë;

- a) Do të fillojë veprimtarinë e shfrytëzimit të TTD brenda periudhës Parapërgatitore;
- b) Do të sigurojë një përdorim optimal të TTD;
- c) Do të sigurojë që Shërbimet të kryhen konform standarteve të shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes si dhe standarteve të sigurisë dhe që ekzistojnë kushte shfrytëzimi të sigurt, funksionale dhe normale e të pandërprera të rrjedhës së trafikut portual;
- d) Do të minimizojë rrjedhën e trafikut në rast aksidentesh apo incidentesh që prekin sigurinë dhe shfrytëzimin e infrastrukturës dhe shërbimeve duke vepruar shpejt dhe gatshëm dhe duke mbajtur lidhje me shërbimet e urgjencës të Autoritetit Kontraktor apo të enteve të tjera;
- e) Do të ketë gati për përdorim të gjitha burimet financiare, teknike, teknologjike, administrative dhe burime të tjera për shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve sipas afateve të përcaktuara në Kontratë;
- f) Përveç rasteve të urgjencës ta shfrytëzojë dhe administrojë infrastrukturën dhe Shërbimet, sipas parimit "kush vjen i pari, shërbehet i pari" (first come, first serve) dhe atij të mosdiskriminimit;
- g) Do të sigurojë ruajtjen në mënyrën e duhur të të dhënave/ regjistrimeve/llogarive që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e TTD si dhe pasqyrimin e saktë të xhiros së kryer dhe të Tarifave të vjela;
- h) Do të pajiset, mbajë të vlefshme dhe zbatojë Lejet, Autorizimet, Liçensat dhe do



të zbatojë Ligjet, përfshirë, por pa u kufizuar, ato që kanë të bëjnë me sigurinë e kalatave, dhe shesheve, ambienteve të brendshme (ujore dhe tokësore) të Zonës së Konçesionit, shëndetit, mjedisit dhe sigurinë në punë.

- i) Nëse do të jetë rasti do të parandalojë, duke kërkuar ndihmën e organeve ligjzbatuese, çdo cënim apo përdorim të paautorizuar të infrastruktures dhe Shërbimeve të Projektit.

12.1.2 Riparimi dhe Mirëmbajtja

1 Konçesionari me shpenzimet e veta:

- a) do të riparojë dhe mirëmbaje TTD apo ndonje pjesë të tyre dhe për këtë qëllim do të marrë masa ruajtje parandaluese dhe do të mirëmbaje TTD përfshirë shkrimin e rrugëve, riparimin e strukturave dhe të pajisjeve dhe furnizimin me to dhe çdo veprimtari tjetër që ka lidhje me mirëmbajtjen.
- b) do të mirëmbajë infrastrukturën dhe Shërbimet e Projektit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate dhe me Praktikën e Industrisë së Mirë me objektivin për të ofruar standarte shërbimi të përshtatshme dhe për të siguruar që asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që do të transferohen tek Autoriteti Kontraktor me mbarimin e Periudhës së Konçesionit të jenë në gjendje të mirë, përjashtuar amortizimin normal.

12.1.3 Zëvendësimi i Pajisjeve

- 1 Konçesionari, me shpenzimet dhe kostot e tij do të planifikojë zëvendësimin në kohë të pajisjeve para se pajisja në fjalë në mënyrë të arsyeshme pritet të prishet dhe do ta zëvendësojë pajisjen në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë, në mënyrë që të sigurojë që infrastruktura dhe Shërbimet e Projektit të jenë në përputhje me kërkesat e Projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së Periudhës Konçesionare.

12.1.4 Riparimet, zëvendësimet apo restaurimet

- 1 Konçesionari me shpenzimet dhe kostot e tij, menjëherë dhe me kujdes do të riparojë, zëvendësojë apo restaurojë TTD apo pjesë të tij të cilat mund të kenë humbur, të jenë dëmtuar apo shkatërruar për faj të Konçesionarit, duke ruajtur cilësinë dhe standartet përcaktuar në këtë Kontratë.



12.1.5 Aksesi për inspektime

- 1 Konçesionari është i detyruar t'i ofrojë të gjithë bashkëpunimin e ekspertëve të caktuar nga Autoriteti Kontraktor për të verifikuar që Projekti/infrastruktura dhe Shërbimet e Projektit janë duke u shfrytëzuar dhe mirëmbajtur në përputhje me standartet e performances dhe që po zbatohen standartet e shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes si dhe standartet e sigurisë. Verifikime të tilla mund kryhen në herë në vit. për më tepër, menjëherë me njoftimin paraprak nga Autoriteti Kontraktor, Konçesionari do t'u ofrojë përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor aksesin e nevojshëm tek asetet Portuale/infrastruktura dhe Shërbimet e Projektit me qëllim inspektimin dhe kontrollin prej tyre të veprimtarisë. Pavarësisht këtij parashikimi me formulim të përgjithshëm, është rënë dakort që Konçesionari veçanërisht do t'u ofrojë bashkëpunim dhe informacion ekspertëve të caktuar nga Autoriteti Kontraktor për të kryer një kontroll lidhur me sigurinë dhe për të verifikuar se Projekti, infrastruktura dhe Shërbimet e Projektit janë në përputhje me standartet e sigurisë.

12.1.6 Raportime

- 1 Konçesionari do t'i paraqesë Autoritetit Portual Durrës raporte mujore lidhur me trafikun e mjeteve lundruese dhe të mallrave.
- 2 Konçesionari duhet të sigurojë në kohë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve si më poshtë:
 - Formularët e Statistikave, Regjistrimit dhe Raportimit;
 - Formularet e detajuar të Statistikave, Regjistrimit dhe Raportimit duke përfshirë statistikën e anijeve, makinave (mjeteve), mallrave, ngarkesave, dhe formularët e Raportimit në lidhje me:
 - i Raportimi i operacioneve të anijeve dhe çështje të tjera detare;
 - ii Raportimi i operacioneve të pasagjerëve dhe mjeteve;
 - iii Raportimi i performancës (produktiviteti) (Performance (productivity) reporting);
 - iv Raportimi i parkimit të mjeteve (Cargo storage reporting);
 - v Raportimi kohës së qëndrimit të mjeteve (Vehicle dwell time reporting);



- vi Raportimi i shkallës së zënies së kalatës, përfshire raportin mbi kohën e punës së anijes dhe kohën e ndenjes pa punë të anijes etj;
- vii Raportimi i numërimit (spontimit);
- viii Raportimi i marrjes dhe dorezimit se Trailerave/Mallrave;
- ix Raportimi i statistikave për pasagjerë, tragetet dhe mjetet;
- x Raportimi i aksidenteve;

- 3 Autoriteti Portual ka të drejten të shtyjë, rregullojë, ose amendojë, në çdo kohë, në mënyrë të arsyeshme detyrimet raportuese të Konçesionarit si dhe mënyrën dhe shpejtësinë e komunikimit me të cilin bie dakort këtu Konçesionari
- 4 Kompetencat dhe detyrimet e auditorëve dhe stafit, caktohen nga Autoriteti Kontraktor për qëllimin e monitorimit të performancës së Konçesionarit dhe nuk do të kalojnë kompetencat dhe detyrimet, siç përcaktohet në kontratë. Sidomos, stafi dhe auditori nuk do të ndërhyjë në punën e Konçesionarit, metodat e menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së terminalit, por do të monitorojnë punën dhe aktivitetet respektive dhe vetëm nëpërmjet aplikimit të treguesve të performancës të pranuar reciprokisht.

12.1.7 Sistemi dhe rrjeti kompjuterik

- 1 Konçesionari do të mirëmbajë sistemet aktuale të teknologjisë së informacionit, dhe të informacionit të TTD, në përputhje dhe në respektim të rregulloreve përkatëse me qëllim garantimin e funksionimit të tyre sipas kërkesave aktuale dhe të ardhshme të TTD.

Në përputhje me Ofertën e Konçesionarit sipas Aneks 2 të Kontratës, Konçesionari është i detyruar të përdorë sistemin e check-in elektronik "e-boarding" të instaluar nga APD. Çdo kërkesë dhe kosto për mirëmbajtjen, rikonfigurimin e këtij sistemi, ndryshime në projektin e tij, mënyrën e funksionimit, zvendesimin e tij, ndryshimin e teknologjisë së informacionit, pas Datës së Fillimit të Operimit, do të jenë nën detyrimet e Konçesionarit. Konkretisht Konçesionari do të pergjigjet për i) Shpenzimet e mirëmbajtjes, pjesëve të këmbimit, suportet e nevojshme softëare dhe hardëare, të sistemit të Checkin elektronik që kanë të bëjnë me funksionet e kontrollin e fluksit të mjeteve dhe pasagjereve në Terminalin e trageteve dhe në portat e hyrje daljeve në Port. ii) Përshtatjet apo adoptimet e mundshme në funksione të sistemit ekzistues apo përmirsimet, rinovimet në funksionalitete të reja që mund të kerkohen gjatë shfrytëzimit iii) Investimet për të zhvilluar me tej këtë sistem që kanë lidhje me veprimtarinë e terminalit



- 2 Konçesionari do të instalojë, përdorë, mirëmbajë sistemet dhe rrjetet teknologjise se informacionit, të reja të propozuara nga ana tij (përfshirë sistemin e shkëmbimit të të dhenave dhe sistemin e komunikimit me APD dhe Kapitenerinë) duke ndjekur të gjitha protokollet që Autoriteti Kontraktor ose APD do të përcaktoje kohë pas kohe. Autoriteti Kontraktor nuk do të nderhyjë në implementimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik ose sistemeve të ngjashme perveç rasteve kur kjo kërkohet nga Ligji.

12.1.8 Çështjet e sigurisë

- 1 Konçesionari veçanërisht lidhur me çështjet e sigurisë do të zbatoje kërkesat e ligjit nr. 9281, date 23.9.2004 "Për sigurine ne anije dhe ne porte" dhe ndryshimet që do të pasojnë pas Datës efektive, dhe akte te tjera nen ligjore ne zbatim te ketij ligji me kusht qe keto akte te mos jene ne kundërshtim me Kodin ISPS.

12.1.9 Punësimi i personelit

- 1 Konçesionari do të punësojë personel të kualifikuar dhe të aftë për të përdorur infrastrukturen dhe për të kryer Shërbimet e Projektit. Kushtet e punësimit mund të përcaktohet sipas nevojave të tij nga Konçesionari, por do të jenë në përputhje me Ligjet dhe Konçesionari të mbaje çdo përgjegjësi në këtë drejtim. Pa prekur formulimin e përgjithshëm të këtij parashikimi, i gjithë dokumentacioni që kërkohet lidhur me punësimin e personelit të huaj do të plotësohet dhe merret para punësimit apo kontraktimit të këtij personeli. Dështimi për të marrë këtë dokumentacion nuk do të përbëjë Forcë Madhore. Të gjithë të punësuarit janë përgjegjesi e Konçesionarit.
- 2 Konçesionari nuk do të lejojë që stafi i tij të punojë në Terminal pa u siguruar që stafi ka kryer së pari kurset elementare të trajnimit të cilat duhet të përfshijnë perfundimin e suksesshëm të kurseve në këto fusha:
 - a) Siguria në përgjithësi (Safety induction)
 - b) Siguria në operimin e mjeteve (Safe equipment operation)
 - c) Mbrojtja e mjedisit (Environmental protection)
 - d) Siguria portuale (Port security) etj
- 3 Autoriteti Portual Durrës do të publikojë performancën e kurseve të trajnimit, duke treguar se cilat nga këto kurse janë të detyrueshme për të gjithë personelin e punësuar në Port, dhe cilat janë të destinuara për aftësi më të larta te stafit.



12.1.10 Punësimi i punonjësve aktualisht në marrdhënie pune me APD

- 1 Koncesionari do te punësoje, nëpërmjet procedurës së transferimit të ndërmarrjes të parashikuar nga Kodi i Punës, punonjesit ekzistues të Terminalit te Trageteve të Autoritetit Portual, sipas listës bashkëngjitur kësaj Kontrate Aneks 7 për të pakën 2 vite në vazhdim dhe do të mbulojë çdo shpenzim apo pretendim të tyre sipas kontratave përkatëse kolektive dhe individuale të punës.
- 2) Menjëherë pas aprovimit së Marrëveshjes, APD do të dorëzojë tek Koncesionari një listë të personave të punësuar aktualisht në Terminalin e Trageteve, sipas Aneks 7 të kësaj kontrate, duke përfshirë pozicionin e punës të personave funksionet dhe vitet e punës në Terminal.

12.2 Të drejtat e Koncesionarit

(i) Fusha e veprimtarisë

Menaxhimi, operimi, mirëmbajta dhe përmiresimi teknik, dhe adaptimi për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin e Trageteve Durrës (TTD) duke përfshirë imbarkimin dhe disimbarkimin e Anijeve te kombinuara per pasagjereve dhe/ose RoRo (tragete, katamarane etj) dhe te Krocereve dhe aktivitete përkatëse të lidhura me to si, ankorimi i anijeve, lëvizja e udhëtareve në terminal, orientimi, depozitimi, magazinimi i mjeteve, pozicionimi, transporti, spontimi, marrja dhe shpërndarja dhe përfshirjen e sigurimin e burimeve të nevojshme që janë mjetet dhe pajisjet, sistemet, praktikat procedurat dhe programet, organizimin dhe burimet njerëzore në përputhje me Praktikën më të mira industriale siç përcaktohet në TeR sië janë të specifikuar në Dokumentat e Tenderit dhe Oferta e Koncesionarit.

(ii) Operacionet

Koncesionari sipas kësaj Kontrate është i autorizuar të ofrojë të gjitha shërbimet dhe të kryejë operacionet që kanë lidhje direkte dhe indirekte me përpunimin e Trageteve dhe të pasagjereve perfshirë imbarkimin disimbarkimin, proceset logjistike etj. sipas Objektivit te Koncesionit dhe Ofertës së Koncesionarit.



12.3 Shërbimet

- 1) Autoriteti Kontraktues do ta asistojë Konçesionarin që gjatë gjithë kohëzgjatjes së Periudhës së Konçesionit t'i sigurohet nga entet perkatese akses në infrastrukture dhe shërbime përfshire por pa u limituar në ujë, energjinë dhe telekomunikimin e nevojshme për zbatimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit/infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit në përputje me Kontratën. Përveçse kur është rënë dakort ndryshe:
- a energjia do të merret në pikë-lidhjen të miratuar nga organi kompetent me shpenzimet e Konçesionarit;
 - b furnizimi me ujë do të merret në pikë-lidhjen të miratuar nga organi kompetent me shpenzimet e Konçesionarit;
 - c Konçesionari me shpenzimet e veta do të instalojë pajisje matëse për të matur konsumin e ujit dhe energjisë. Autoriteti Kontraktor dhe ose APD do të sigurojë mbështetjen dhe bashkëpunimin për garantimin e cilësisë dhe sasisë së shërbimit të nevojshëm të furnizimit të terminalit.
 - d Konçesionari pranon rrjetin e furnizimi me energji, ujë dhe rrjetit të telekomunikacionit në TTD të instaluar nga APD, si dhe pranon çdo kosto shtesë që lidhet me mirëmbajtjen dhe ndryshimet teknologjike në lidhje me funksionimin e tij në të ardhmen.

NENI 13 TE DREJTA, DETYRA DHE DETYRIME TE PËRGJITHSHME

13.1 Të Konçesionarit

13.1.1 Lejet e aplikueshme

Konçesionari, gjatë kohëzgjatjes së Periudhës së Konçesionit, duhet të zbatojë dhe të jetë në përputhje me Lejet, Autorizimet, Liçensat për kryerjen e shërbimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

13.1.2 Taksat dhe detyrimet fiskale

Konçesionari, gjatë Periudhës së Konçesionit, duhet të paguajë në mënyrë të rregullt të gjitha tarifatat Konçesionare, Pagesën Konçesionare (Royalty), taksat, tatimet, detyrimet, T.V.SH-ne, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarve,



tatimin mbi të ardhurat, detyrimet për taksat indirekte, detyrimet doganore, taksat e shërbimeve të cilat mund të vilen, të merren ose të përfitohen në çdo kohë sipas Ligjit nga çdo Ent apo organ Shtetëror duke përfshire ato, për asetet e luajtshme dhe të paluajtshme dhe Shërbimet.

13.1.3 Bashkëpunimi me organet shtetërore që operojnë në TTD

- 1 Koncesionari, në rolin e Operatorit të terminalit do të bashkëpunojë ngushtësisht me institucionet shtetërore të cilat operojnë në TTD, Drejtoria e Policisë së Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Doganës, duke siguruar për to ambientet e punës dhe kushte të përshtatme, me qëllim ushtrimin e aktivitetit në terminal. Koncesionari do të respektojë rregulloret institucionale të organeve shtetërore si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të Autoritetit Kontraktor dhe/ose Autoritetit Portual apo organeve të tjera për kryerjen e veprimtarive dhe ushtrimin e kompetencave të tyre në Zonën Koncesionare.
- 2 Koncesionari do të veprojë për sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe të mjediseve, si dhe për përballimin e shpenzimeve, që lindin gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes së mjediseve të kalimit të kufirit, të domosdoshme për kryerjen me efikasitet të kontrollit kufitar, si dhe të sigurohet që operacionet e tij, dhe të tpusuarve të tij janë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin mbi kontrollin e kufirit dhe migracionit.
- 3 Koncesionari do të respektojë kërkesat ligjore si dhe rregulloret e Autoritetit Kontraktor dhe/ose APD mbi respektimin dhe mbrotjen e mjedisit në TTD.
- 4 Koncesionari duhet të respektojë kërkesat dhe të drejtat e linjave të trageteve, për të operuar në TTD, sipas kapaciteteve të këtij terminali. Koncesionari duhet të kërkojë agjentëve dhe kompanive operuese përmbushjen e kërkesave ligjore në fuqi dhe operacionale në lidhje me operimin.

13.1.3 Detyrime Shtesë

- 1 Jashtë vlerës së çmimit të Kontrates, Koncesionari gjatë periudhës së shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes do të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet direkte përfshire taksat jo direkte, faturat dhe taksta e çdo lloji apo natyre të lidhura me fuqinë punëtore të punësuar nga Shoqëria Koncesionare nëpërmjet transferimit të punonjësve nga APD tek Koncesionari/Shoqëria Koncesionare.
- 2 Koncesionari do të organizojë financimin e investimeve të kërkuara dhe të rëna dakord dhe operacionet dhe të mbajë të gjitha kostot për përmirësimin teknik të infrastrukturës të terminalit, të sigurojë mjetet dhe makineritë, paisjet shtesë, sistemet kompjuterike, fuqinë punëtore dhe për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte që



lidhen me detyrimin për të ofruar shërbimet në Terminalin e Trageteve dhe këtu perfshihet, ndër të tjera, të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin, siguria, energjia, karburanti, elektriciteti, uji, komunikim, siguri etj.

13.1.4 Të tjera

- 1 Konçesionari bie dakort që, me shpenzimet e veta, të paktën 6 (gjashtë) muaj para mbarimit të Periudhës së Konçesionit, nëpërmjet nje eksperti të pavarur të caktuar me pëlqimin e përbashket të Palëve, të kryejë një analizë të kushteve dhe një inventar të gjithë infrastrukturës dhe Shërbimeve të Projektit. Nëse, si rezultat i një studimi dhe inventari të tillë, eksperti i pavarur ka vënë re se asetet e portit dhe/ose infrastruktura dhe Shërbimet e Projektit ose ndonje pjesë e tyre nuk janë mbajtur e shfrytëzuar në përputhje me kërkesat e kësaj Kontrate (përfshirë amortizimin normal) Konçesionari duhet, me shpenzimet dhe kostot e veta, të ndermarrs ts gjitha hapat e nevojshëm për t'i rikthyer në të njëjtën gjendje të mirë pune këto materiale apo prona para datës së transferimit.

13.2 Të Autoritetit Kontraktor dhe/ose Autoritetit Portual Durrës

13.2.1 Transferimi i Aseteve

- 1 Me nënshkrimin e kontratës, Autoriteti Portual Durrës dhe Konçesionari do të kryejnë transferimin e asetëve të terminalit në gjendjen qe jane. Termat dhe kushtet e marrëveshjes se transferimit te asetëve do te jene ne perputhje me Protokollin e dorëzimit që do të mbahet nga APD pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, duke mbajtur në konsideratë si më poshtë:
 - a) Transferimi i infrastrukturës
 - Sipas afateve të percaktuara në kontrate, Autoriteti Portual Durrës (ne rolin e administruesit te pronës shtetërore), do të transferoje dhe Konçesionari duhet të pranojë transferimin e shesheve të përpunimit të terminalit te trageteve dhe kroçereve si dhe territoret e tjera sipas kufijve aktuale të terminalit (zona e koncesionit), kundrejt tarifës se qerase/m² (leasing fee) percaktuar ne nenin 8.3.1/1 të Kontratës.
 - Sipas afateve të përcaktuara në kontrate, Autoriteti Portual Durrës (ne rolin e administruesit te pronës shtetërore), do te transferoje dhe Koncesionari duhet te pranoje transferimin e shesheve të përpunimit te TTD si dhe te godines se terminalit te pasagjereve dhe territoret e tjera sipas kufijve aktuale të Terminalit (zona e koncesionit) kundrejt tarifës së qerase/m² (leasing fee) percaktuar ne nenin 8.3.1/1 të Kontratës.



- Për çdo sipërfaqe shtesë, e cila do t'i vihet në dispozicion perspektivës së zhvillimit të Terminalit (kufijtë e zgjerimit) Autoriteti Portual Durres do të transferojë dhe Konçesionari do të pranojë, transferimin e sipërfaqeve shtesë kundrejt tarifës së qerasë (leasing fee) përcaktuar në nenin 8.3.1/1 të Kontratës.

- b) Transferimi i mjeteve dhe pajisjeve
 - Sipas afateve të përcaktuara në kontratë, Autoriteti Portual Durrës do të transferojë dhe Konçesionari duhet të pranojë transferimin e mjeteve dhe pajisjeve aktuale që operojnë në terminal, të përcaktuara nga APD të cilat i shërbejnë këtij Koncesioni.

 - Në çdo rast, kushtet për transferimin mjeteve dhe pajisjeve, do të jenë sipas përcaktimeve të Aneks 6 të Kontratës:
 - i Çmimi i transferimit të mjeteve dhe pajisjeve do të përcaktohet në Aneks 6, dhe do të jetë jo më pak se vlera e mbetur e asetit sipas regjistrave kontabël të Autoritetit Portual në ditën e transferimit.
 - ii Mjetet dhe pajisjet do të transferohen në gjendjen dhe statusin që janë pa detyrime shtesë nga Autoriteti Portual;
 - iii Të drejtat mbi mjetet dhe pajisjet që transferohen nga Autoriteti Portual Durrës për Konçesionarin, do të jenë për të gjithë periudhën e Koncesionit.

- 2 APD do të transferojë për Konçesionarin, kontratat e shërbimit të cilat janë në proces zbatimi dhe që mbulojnë fushat e mëposhtme :
 - a Mirëmbajtja e IT

 - b Mirëmbajtja e infrastruktures së inxhinierisë civile

 - c Mirëmbajtja e infrastruktures energjitike

 - d Mirëmbajtja e Mjeteve dhe Mekanizmave të APD

 - E Shërbimet e pastrimit të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të TTD



Këto kontrata janë të lidhura me operatorë privatë të specializuar sipas procedurave tenderuese të kryera nga APD. Koncesionari pranon dhe do të marrë përsiper transferimin e këtyre kontratave me kushtet siç janë deri në përfundim të afatit të këtyre kontratave.

Të gjitha detyrimet në lidhje me ekzekutimin e kontratave si më sipër, pagesat, marrëdhëniet me kontraktorët si dhe mbulimi i shpenzimeve apo pretendim të tyre, të cilat do të lindin pas Datës së Fillimit të Operimit do të jenë për llogari të Koncesionarit

- 3 Për subjektet e tjera të cilat kanë kontrata qeraje apo operimi në TTD, Autoriteti Kontraktor dhe APD marrin përsiper të kryejnë mbylljen e këtyre kontratave apo transferimin e tyre (sipas rastit) dhe/ose kalimin e këtyre zonave në përgjegjësi të administrimit të Koncesionarit brenda periudhës parapergatitore (deri në Datën e Fillimit të Operimit).
- 4 Autoriteti Kontraktor ose Autoriteti Portual Durres, ashtu si mund të jete rasti, do të informojë Koncesionarin në lidhje me veprimet që duhet të ndermerren në përputhje me pikën 1, 2 dhe 3 të këtij neni 13.2.1.

13.3 Detyrimi për bashkëpunim dhe respektim të të drejtave

- 1 Palët duhet të bashkëpunojnë me korrektësi, në mirëbesim dhe pa vonesë me njera-tjetren në mënyrë që të arrihen objektivat e kësaj Kontrate.
- 2 Kjo Kontratë dhe të drejtat, koncesionet dhe privilegjet e përcaktuara këtu, përbejnë të drejta të cilat i janë dhënë Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare dhe përveç kur palët bien dakord me marrveshje këto të drejta nuk mund të revokohen gjatë Periudhës së Koncesionit.

NENI 14 DËMSHPËRBLIMI

- 1 Koncesionari do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit ndaj Autoritetit Kontraktor që vjen si rezultat ose pasojë e çdo Rasti Mospërmbushjeje nga ana e tij, me kusht që kjo shkelje të mos jetë shkaktuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë nga një ndryshim në Ligj.
- 2 Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit ndaj Koncesionarit që vjen si rezultat ose pasojë e çdo Rasti Mospërmbushjeje nga ana e tij, me kusht që kjo shkelje të mos jetë shkaktuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë nga një ndryshim në Ligj.



- 3 Palet do të rregullojnë gjithë pretendimet dhe kërkesat kundrejt njerë tjetrës, dhe do të rimbursojnë ose ruajnë nga dëmtimet Palën tjetër si dhe punonjësit e saj në lidhje me humbje dhe/ose dëme të shkaktuara dhe/ose kosto, tarifa/shpenzime të bera dhe/ose gjoba të vëna dhe/ose ndonjë ankesë për shkak të lëndimit ose vdekjes së çdo personi dhe/ose humbjes ose dëmtimit të shkaktuar ose të pësuar nga pronat në pronesi ose që i përkasin Palës tjetër të shkaktuara nga veprimet e Palës tjetër, dhe/ose punonjësit e saj, nëpunësit apo agjentet.
- 4 Në rastet kur palët nuk bien dakord për përmbushjen e detyrimeve sipas pikës 1 me lart atëherë pretendimet që lindin sipas pikës 3 më lart do të rregullohen sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.
- 5 Shpërblimi i dëmit mund të kërkohej sipas rastit nga Konçesionari ose Autoriteti Kontraktor, pa cënuar ushtrimin e të drejtave të tjera në këtë Kontratë.
6. Në të gjitha rastet Pala që vendos ose pretendon të drejtën për t'iu shpërblyer dëmi në përputhje me këtë Kontratë do të ketë detyrimin të marrë të gjitha masat për të pakësuar efektet e dëmit të ndodhur, duke marrë parasysh se ajo mund ta bëjë këtë pa shkaktuar shpenzime të paarsyeshme.

NENI 15 KONFIDENCIALITETI

- 1 Të gjitha të dhënat dhe dokumentet konfidenciale (financiare, teknike apo të çdo lloji tjetër) të dhëna nga njëra Palë, Palës tjetër, përveç kur është detyrim ligjor apo rezultat i një kërkesë apo urdhri nga organet kompetente shtetërore, nuk duhet t'i bëhen të njohura të treta, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, me përjashtim të dhënies së informacioneve në kushte domosdoshmërie keshilltarëve ligjorë/auditeve të palës së interesuar apo nënkontraktoreve të Konçesionarit në masën e nevojshme për të përmbushur nën-kontratën. Ky parashikim do të jetë i vlefshëm deri në tre vjet pas përfundimit të Periudhës së Konçensionit.
- 2 Konçesionari dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidence të gjitha dokumentat, të dhenat dhe informacionet e cilësuar si konfidenciale të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 3 Konçesionari mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktorin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Operatori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në pikën 1 dhe 2 më sipër.



NENI 16 FORCA MADHORE

- 1 "Force Madhore" do te thote çdo rrethane qe ne menyre te arsyeshme dhe objektive eshte tej parashikimit dhe kontrollit, te drejtperdrejte ose te terthorte, te pales se cenuar ("Pala e Cenuar") qe rezulton ose shkakton pamundesi te plote ose te pjesshme te Pales se Cenuar per te permbushur ndonje prej detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate, por vetem nese dhe ne masen qe:
 - i) kjo rrethane, pavaresisht ushtrimit te kujdesit te arsyeshem, nuk mund te parandalohet apo nuk ishte e mundur te parandalohet, shmangej ose menjanohet nga Pala e Cenuar;
 - ii) Pala e Cenuar ka marre te gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative ne menyre qe te shmangte pasojen e ketij rasti ne aftesine e Pales se Cenuar per te permbushur detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate dhe per te zbutur pasojat e saj;
 - iii) ngjarja nuk eshte, ose nuk ka qene pasoje e drejtperdrejte ose e terthorte e shkeljes nga Pala e Cenuar te ndonje prej detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate, dhe
 - iv) Pala e Cenuar t'i kete dhene njoftim Pales tjeter ("Pala e Pacenuar").
- 2 Rastet e Forces Madhore perfshijne rrethanat e meposhtme, por pa u kufizuar vetem ne to:
 - i) veprimet e luftes, pushtimi ose akti i nje armiku te jashtem, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;
 - ii) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat ne vendin e punes, grevat e pergjithshme ose lokale, grevat e natyres politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;
 - iii) rufeja, zjarri, termeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonje fatkeqesi tjeter natyrore;
 - iv) epidemite ose murtaja; dhe
 - v) çdo akt sabotimi, drejtim i keq/krim i organizuar dhe/ose aktivite pune qe imponojne apo pengojne zbatimin e saj.



- 3 Pala e cenuar do te perjashtohet nga permbushja e detyrimeve, dhe nuk do te quhet se eshte ne mospermbushje ne lidhje me Kontraten e Konçesionit per aq kohe, dhe ne ate mase, sa zgjat pamundesia objektive per te permbushur detyrimet si dhe Periudha e Konçesionit do te shtyhet automatikisht per aq sa do te zgjase Ngjarja e Forces Madhore.
- 4 Ne se ndodh ndonje situate e Forces Madhore, Koncesionari duhet të njoftoje menjehere Autoriteti Kontraktor. Me perjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Koncesionari duhet të vazhdoje të zbatoje detyrimet e tij sipas kontrates në masen praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kerkoje të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin qe nuk pengohet nga Forca Madhore.
- 5 Koncesionari nuk do të jetë përgjegjës dhe nuk do të humbasë garancinë e kontrates, nuk do të penalizohet dhe nuk do të ndërpritet kontrata me të, në rast mosplotesimi nëse dhe deri në masen qe vonesa në zbatim ose ndonje mospërmbushje të detyrimeve të tij sipas kontrates vjen si rezultat i Forces Madhore.

NENI 17 KUFIJTË E PENALITETEVE

- 1 Kufijtë e penaliteteve që duhet të paguajë Koncesionari/Shoqëria Koncesionare për moszbatim të detyrimeve në përputhje me afatet dhe mënyrën e rënë dakord në këtë Kontratë dhe në Anekset e saj, do të jenë ato të parashikuara në Aneksin 8. Pagimi i çfarëdolloj penaliteti nuk do të zhveshë Konçesionarin nga përgjegjësia për të ekzekutuar detyrimin apo për të paguar dëmin e shkaktuar në rast se ky kalon penalitetin.

NENI 18 ZGJIDHJA E KONTRATËS

18.1 Rastet e Mospërmbushjes

18.1.1 Rastet e Mospërmbushjes nga Konçesionari

- 1 Secili prej rasteve të mëposhtme do të përbëjë një “ Rast Mospërmbushjeje nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare”, përvec kur kjo vjen për shkak të Rasteve të Forcës Madhore:
 - A Konçesionari, me vendim gjykate të formës së prerë, dënohet për ndonjë akt korruptiv apo për se ka dhënë deklarime dhe ka paraqitur dokumenta të falsifikuara gjatë procedurës konkurruese dhe të përzgjedhjes si fitues i këtij Konçesionit;



- B Finalizimi i paaftësisë paguese apo deklarimi i falimentimit;
- C Çdo deklarim i bërë ose garanci e dhënë nga Konçesionari sipas kësaj Kontrate zbulohet të jetë fals ose i pasaktë;
- D Braktisja e menaxhimit dhe mirëmbajtjes të Objektivit të Konçesionit nga Konçesionari;
- E Shoqëria Konçesionare qëllimisht dhe me vetëdije urdhëron, udhëzon, angazhon ose lejon me vetëdije një prej punonjësve, furnizuesve, nënkontraktoreve ose përfaqësuesve të ndërmarrin veprime të cilat ndalohen ose përbejnë shkelje të kësaj Kontrate dhe/ose Ligjit.
- Ë Konçesionari nuk ka përmbushur ndonjë prej detyrimeve të tij në afatit e duhur sipas Kontratës dhe nuk ka arritur që brenda afatit përkatës të korrigjimit të caktuar në këtë Kontratë për një rast specifik, ose kur nuk bëhet fjalë për këtë rast, brenda afatit të korrigjimit të njoftuar Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktor, të ndreqë këtë mospërmbushje.
- F Çdo shkelje e kësaj Kontrate, që për nga natyra dhe pasojat e saj është thelbësore, pavarësisht nëse është përcaktuar ose jo shprehimisht si e tillë në këtë Kontratë;

18.1.2 Rasti i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose APD

- 1 Secili prej rasteve të mëposhtme do të përbëjë një "Rast Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose APD":
 - a Dështimi për të përmbushur detyrimet lidhur me Lejet, Licensat, Autorizimet, të cilat duhet të sigurohen nga Autoriteti Kontraktor apo APD sipas Ligjit me kusht që Konçesionari të ketë paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor;
 - b Çdo shkelje e kësaj Kontrate, që për nga natyra dhe pasojat e saj është thelbësore, pavarësisht nëse është përcaktuar si e tillë ose jo në këtë Kontratë.
 - c Çdo informacion i dhënë nga Autoriteti Kontraktor ka qenë fals, i pasaktë dhe jo i vërtetë;



18.1.3 Te drejtat e palëve në rast mospërmbushje

- 1 Pas shfaqjes se nje rasti mospërmbushje sipas nenit 18.1 më sipër nga ana e Konçesionarit, dhe ne rast mosndreqeje te mospërmbushjes sipas pikes 18.2.2, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zgjidhë Kontratën.
- 2 Pas shfaqjes se mospërmbushjes sipas nenit - 18.1.2 më sipër nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe/ose APD i cili nuk mund te ndreqet sipas pikes 18.2.4, Konçesionari ka të drejtë të zgjidhë Kontratën.
- 3 Secila Palë, do të marrë në konsideratë natyrën e shkakut të mospërmbushjes dhe do të ndjekë procedurën për zgjidhje paqësore përpara se të procedoje me zgjidhjen e Kontrates sipas parashikimeve te pikes 18.2.2.

18.2 Proçedura e Zgjidhjes së Kontratës

18.2.1 Zgjidhja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktor mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Konçesionarit një Njoftim për Zgjidhje në qoftë se ka ndodhur një Rast Mospërmbushjeje nga Konçesionari që është duke vazhduar për më shumë se 30 ditë pas dërgimit nga Autoriteti Kontraktor të Koncesionarit të njoftimit për këtë Rast Mospërmbushjeje nga Konçesionari ose ka ndodhur një Rast i Forcës Madhore, i cili vazhdon për një periudhë për më shumë se 6 muaj.

18.2.2 Plani i rregullimit

- a Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas dërgimit të njoftimit nga Autoriteti Kontraktor te Konçesionari për ekzistencën e një Rasti Mospërmbushjeje nga Konçesionari, Konçesionari mund t'i propozojë Autoritetit Kontraktues një Plan Rregullimi. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së tij, Autoriteti Kontraktues do të shprehet nëse e pranon ose e refuzon këtë Plan Rregullimi, si dhe do të njoftojë menjëherë Koncesionarin për refuzimin ose pranimin.
- b Nëse Autoriteti Kontraktor refuzon planin e rregullimit, Konçesionari do të ketë të drejtën e një periudhe 10 (dhjetë) ditore për të ndrequr Rastin e Mospërmbushjes (që nga data e njoftimit për refuzimin nga Autoriteti Kontraktues), periudhë pas së cilës Autoriteti Kontraktor mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Koncesionarit Njoftim për Zgjidhje nëse Rasti përkatës i Mospërmbushjes nuk është ndrequr ende.
- c Nëse Autoriteti Kontraktor e miraton Planin e Rregullimit, miratim i cili nuk do të



refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, Konçesionarit do t'i kërkohet të zbatojë me përpikmëri këtë Plan Rregullimi. Në rast se Konçesionari nuk e ka ndrequr këtë Rast Mospërbushje në mbarim të periudhës kohore të përcaktuar në Planin e Rregullimit, Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtë t'i japë Konçesionarit Njoftim për Zgjidhje.

18.2.3 Ndreqja nga Autoriteti Kontraktor

Në rastin e një Rasti Mospërbushjeje nga Konçesionari, Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtë, por nuk është i detyruar të ndreqë ose të përpiket të ndreqë këtë Rast Mospërbushjeje duke:

- i Punësuar palë të treta për të ndrequr avaritë, vonesat dhe mospërbushjet që përbëjnë Rastin e Mospërbushjes nga Konçesionari, ose duke e bërë vetë këtë gjë;
- ii I faturuar Konçesionarit të gjitha kostot dhe shpenzimet faktike dhe të justifikuar si duhet, që janë bërë në lidhje me këto ndërmarrje (të kryera si nga palët e treta ashtu edhe nga vetë Autoriteti Kontraktues) dhe
- iii Tërhequr nga Garancia e Kontratës cdo shumë për t'u paguar nga Konçesionari në përputhje me nënparagrafin (ii) më sipër dhe që është ende për t'u paguar tridhjetë (30) ditë pas njoftimit të Konçesionarit nga Autoriteti Kontraktor, me anë të të cilit kërkohet pagesa e tyre dhe, për heqjen e çdo dyshimi, Konçesionari do të jetë i detyruar t'i bëjë Autoritetit Kontraktor pas një kërkese, pagesa të drejtëpërdrejta për këto shuma nëse shuma e tyre e kalon shumën e Garancisë së Kontratës).

18.2.4 Zgjidhja e Kontratës nga Konçesionari

- 1 Konçesionari mund ta zgjidhë këtë Kontratë duke i dhënë Autoritetit Kontraktues një Njoftim për Zgjidhje bazuar në një Rast Mospërbushjeje nga Autoriteti Kontraktues, i cili nuk është kryer brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i tij tek Autoriteti Kontraktor ose ka ndodhur një Rast i Forcës Madhore, i cili vazhdon për një periudhë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

18.2.5 Pagesat e Zgjidhjes së Kontratës

- 1 Në rast zgjidhjeje të kësaj Kontrate për faj të Autoritetit Kontraktor, ky i fundit detyrohet t'i paguajë Konçesionarit kompensimin sipas strukturës që vijon:
 - a 100% të Vlerës së Investimit të kryer por gjithmonë jo më i madh se 80 % e vlerës së investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate, plus 8% të



vlërës së investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë 5 viteve të para;

- b 80% e Vlerës së Investimit të kryer, plus 8% të vlerës së investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të gjashtë deri në vitin e dhjetë;
 - c 40 % e Vlerës së Investimit të kryer, plus 8% të vlerës së investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të njëmbëdhjetë deri në vitin e pesëmbëdhjetë.
 - d 20% e Vlerës së Investimit të kryer, plus 8% të vlerës së investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate në rast zgjidhjeje të Kontratës gjatë vitit të gjashtëmbëdhjetë deri në vitin e njëzetë.
 - e 10% e Vlerës së Investimit të kryer, plus 8% të vlerës së investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate në rast zgjidhjeje të Kontratës për vitet në vazhdim
 - f Të gjitha investimet e kryera deri në momentin e zgjidhjes së kontratës mbeten pronë e Autoritetit Kontraktor.
 - g Për efekt përlogaritje Vlera e Investimit të kryer sipas këtij neni nuk mund të kalojë vlerën e investimit të përcaktuar në nenin 8.6 të Kontratës. Kjo dispozitë nuk nënkupton se Konçesionari nuk mund të kryejë investim me vlerë më të madhe se ai i përcaktuar në nenin 8.6 të kësaj Kontrate, gjatë Periudhës Konçesionare.
- 2 Në rast zgjidhjeje të kësaj Kontrate për faj të Koncesionarit, ky i fundit i detyrohet Autoritetit Kontraktor kompensimin sipas strukturës që vijon:
- a Në rast të zgjidhjes së kontratës gjatë pesë viteve të para, kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktor të investimit total të kryer sipas përcaktimit në Planin e Investimit referuar Dokumenteve të Tenderit dhe Propozimit Financiar. Në rast se vlera e investimit të kryer është më pak se sa është parashikuar në Planin e Investimit, atëherë Koncesionari përveç transferimit të investimit në pronësi të Autoritetit Kontraktor, i kompenson këtij të fundit financiarisht diferencën.
 - b kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktues të investimit total të kryer plus 8% të vlerës së investimit që duhet të kryhej sipas Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të gjashtë dhe të shtatë;
 - c kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktor të investimit total të kryer sipas përcaktimit në Planin e Investimit referuar Dokumenteve të Tenderit dhe



Propozimit Finaciar, plus 8% të vlerës së investimit që duhet të kryhej sipas Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të tetë. Në rast se vlera e investimit të kryer është më pak se sa është parashikuar në Planin e Investimit, atëherë Koncesionari prvec transferimit të investimit në pronësi të Autoritetit Kontraktor, i kompenson këtij të fundit financiarisht diferencën;

- d kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktor të investimit total të kryer plus 8% të vlerës së investimit që duhet të kryhej sipas Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të nëntë;
- e kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktor të investimit total të kryer sipas përcaktimit në Planin e Investimit referuar Dokumenteve Standarte te Tenderit dhe Propozimit Finaciar, plus 8% të vlerës së investimit që duhet të kryhej sipas Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të dhjetë. Në rast se vlera e investimit të kryer është më pak se sa është parashikuar në Planin e Investimit, atëherë Koncesionari prvec transferimit të investimit në pronësi të Autoritetit Kontraktues, i kompenson ktij të fundit financiarisht diferencën;
- f kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktor të investimit total të kryer sipas nenit 8.6 të Kontratës, plus 7% të vlerës së investimit që duhet të kryhej sipas Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të njëmbëdhjetë deri në vitin e pesëmbëdhjetë
- g kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktues të investimit total të kryer sipas nenit 8.6 të Kontratës, plus 6 % të vlerës së investimit total të kryer Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të gjashtëmbëdhjetë deri në vitin e njëzetë;
- h kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktues të investimit total të kryer sipas nenit 8.6 të Kontratës, plus 6 % të vlerës së investimit total të kryer Planit të Investimit sipas nenit 8.6 të Kontratës, në rast të zgjidhjes gjatë vitit të njezetenjë deri në vitin e njëzetëepestë.

18.3 Përfundimi i Kontratës për shkak të Forcës Madhore

- 1 Nëse një rast i Forcës Madhore vazhdon ose me gjykimin e drejtë të Palëve, ka mundësi të vazhdojë për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj të njëpasnjëshëm, secila Palë mund të përfundoj këtë Kontratë, duke i dhënë një Njoftim Përfundimi Palës tjetër. Nëse Kontrata zgjidhet si pasojë e Forcës Madhore, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti kompensimin e plotë të vlerës së aseteve të tij në momentin e zgjidhjes së Kontratës, me kusht që asetet të ekzistojnë dhe të jenë funksionale.



18.4 Njoftimi i përfundimit

- 1 Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e Kontratës në përputhje me nenin 18, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi i Përfundimit duhet të përmbajë
 - I Detajet e duhura duke nënvizuar Ngjarjet e Shkakut;
 - li Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;
 - lii Përfundimi i Pagesës, përfshirë dhe hollësitë e llogaritjes dhe;
 - (iv) Cdo informacion tjetër të rëndësishëm;

18.5 Transferimi i kompetencave te Autoriteti Kontraktor dhe te Autoritetit Portual të Durrësit

- 1 Nëse detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktor dhe Autoritetit Portual të Durrësit, i transferohen një tjetër organi shtetëror përmes marrëveshjeve legislative, kjo agjenci apo institucioni i ri do të zëvendësojë Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetin Portual të Durrësit.

18.6 Zëvendësimi i Konçesionarit

- 1 Pavarësisht nga sa më sipër, Njoftimi i Përfundimit konsiderohet të jetë tërhequr, nëse, para hyrjes së tij në fuqi, Konçesionari vendos në pajtim me Ligjin, të
 - I realizojnë një peng mbi kuotën e zakonshme dhe/ose
 - li të propozojnë transferimin e Projektit tek një ekip zëvendës menaxherial ose një subjekt zëvendës për qëllimet e sigurimit të vazhdimsisë së Projektit
- 2 Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor:
 - I nuk mban në mënyrë të paarsyeshme ose vonon pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar i menaxhimit ka ekspertizën, aftësinë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën si ato të Konçesionarit dhe
 - li kryen të gjitha veprimet që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim.



18.7 Zgjidhja e Kontratës për dështim/mospërbushje nga Autoriteti Kontraktor

Ne rast zgjidhje te kontrates per interes publik apo Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues ose APD, Konçesionari ka te drejte t'i drejtohet gjykates per percaktimin e shumes se demshperblimit qe i takon atij si palë e dëmtuar.

18.8 Detyrime gjatë periudhës së përfundimit

- 1 Perveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë deri ne datën e përfundimit ose mbarimit, Palët do të vazhdojnë të përbushin detyrimet e tyre respektive, për aq sa këto detyrime mund të përbushen, me qëllim për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara për përdoruesit/klientët e Portit. Pala që nuk do të mund të përbushë këto detyrime, duke sjell pasoja negative tek përdoruesit/klientët, do të kompensojë Palën tjetër për çdo dëm apo humbje të shkaktuar.

18.9 Pasoja të tjera të përfundimit

- 1 Pavarësisht pasojave apo kërkesave të tjera sipas kësaj kontrate apo Ligjit:
 - a) Konçesionari do të transferojë Autoritetit Kontraktor të gjitha asetet dhe të drejtat si rezultat i mbarimit të Periudhës Konçesionare, apo i zgjidhjes së Kontratës;
 - b) Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtë të arketojë çdo garanci bankare të leshuar nga Konçesionari për çdo shumë që Konçesionari është debitor ndaj Autoritetit Kontraktor.
 - c) Çdo policë sigurimi do të kalojë ne emër të Autoritetit Kontraktor, i cili do te jetë i vetmi përfitues prej tyre nëse do të jete rasti.
 - d) Mbarimi i Periudhës së Koncesionit, apo përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate (sido që të ndodhë ai), nuk duhet të çënojë të drejtat apo ligjshmërinë e çdonjëres prej Palëve në këtë Kontratë, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të veprojë edhe pas përfundimit apo mbarimit të saj (kësaj Kontrate) mbi parashikimet e dispozitave përkatëse të kësaj Kontrate.

NENI 19 TRANSFERIMI I TTD PAS PËRFUNDIMIT TE PERIUdhës SË KONÇESIONIT

19.1 Transferimi i TTD

- 1 Konçesionari, duke filluar nga 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të Periudhës Konçesionare, do te fillojë gradualisht transferimin tek Autoriteti Kontraktor të:



- i) TTD-së dhe të gjitha asetet e tij do të transferohen të lira nga çdo barrë apo pengese;
- ii) Të gjitha dokumentat, kontratat e lidhura me organizimin dhe administrimin e TTD;
- iii) Të gjithë rrjetin dhe sistemet softëare/kompjuterike dhe licencat e duhura përfshirë këtu të drejtat e pronësisë intelektuale të përfshira aty, të përdorura gjatë zbatimit të Kontratës së Konçesionit.

2 Përveç parashikimeve në pikat e mësipërme, Konçesionari duhet të transferojë infrastrukturën e nevojshme në gjendje funksionale pune. Konçesionari duhet, në veçanti, të transferojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një shërbim normal dhe pandërprerje. Nëse pajisje të nevojshme për shërbimin nuk transferohen nga Konçesionari për çfarëdolloj arsyeje (për shembull duke argumentuar që nuk janë në pronësi të tij por janë të marra me qira nga palë të treta, duke argumentuar që janë sekuestruar nga pale të treta etj...) atëhere ai detyrohet të derdhë për llogari të Autoritetit Kontraktor kundërvlerën monetare (vlera e re në momentin e transferimit) të kesaj infrastrukture që mungon dhe Autoriteti Kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar fitimin e munguar. Konçesionari jep garanci për një periudhë një vjeçare pas datës transferimit për mirefunksionimin e infrastrukturës. Në përputhje me këtë garanci Konçesionari detyrohet të zëvendësojë çdo pjesë të infrastrukturës (të luajtshme apo të paluajtshme) që nuk është në gjendje pune.

3 Autoriteti Kontraktues mund të bëjë në çdo kohë një inventar të infrastrukturës (luajtshme apo të paluajtshme) që ndodhet në Zonën e Konçesionit. Ky inventar është i detyrueshëm në vitin e pestë përpara datës së përfundimit të Konçesionit dhe në vitin e fundit përpara datës së përfundimit të Konçesionit. Nëse gjatë inventareve rezultojnë se pajisje esenciale për shfrytëzimin normal të aktiviteteve objekt të këtij Konçesionit nuk janë në gjendje pune ose janë në Zonën e Konçesionit por janë në pronësi të palëve të treta (pra janë marrë me qira nga Konçesionari për tu përdorur në Zonën e Konçesionit) atëhere Autoriteti Kontraktor do t'i rikujtoj me shkrim Konçesionarit detyrimin e tij që në bazë të kësaj kontrate duhet të transferojë infrastrukturën e nevojshme për një shërbim normal dhe të pandërprerë.

19.2 Transferimi i vonuar

- 1 Nëse, Konçesionari nuk arrin të transferojë të Drejtat Konçesionare në përfundim të Periudhës Konçesionare, përjashtuar ato që i atribuohen Autoritetit Kontraktor, Konçesionari është i detyruar:
- 2 të mbledhë dhe administrojë për llogari të Autoritetit Kontraktues të ardhurat bruto minus kostot operative dhe detyrimet ligjore që lidhen me këtë veprimtari për sa i përket të Drejtave konçesionare për sa kohë që vonesa e Konçesionarit vazhdon të



ekzistojë.

- 3 Në rast se transferimi i asetëve nga Konçisionari tek Autoriteti Kontraktues është vonuar për arsye që i atribuohen Autoritetit Kontraktor, Konçisionari do të vazhdojë të shfrytëzojë Infrastrukturen dhe Shërbimet e Projektit sikur Kontrata të ishte në ekzekutim e sipër duke kryer karshi Autoritetit Kontraktues të gjitha pagesat sipas nenit 8 "Çështje Financiare".

19.3 Risku

- 1 Deri në transferimin e plotë të Drejtave Konçisionare nga Konçisionari tek Autoriteti Kontraktues, të gjitha dhe çdo risk i lidhur me TTD do të mbeten me Konçisionarin

NENI 20 MJETET E RIPARIMIT/DËMSHPERBLIMIT KUMULATIVE

- 1 Ushtrimi i të drejtave nga secila Pale për të zgjidhur Kontraten, siç parashikohet në të, nuk do të pengojnë atë Pale të kërkojë ndonjë të drejtë tjetër apo mjet riparimi që mund të ekzistojë sipas ligjit. Të gjitha mjetet e riparimit/dëmshperblimit në dispozicion të Paleve do të jenë kumulative dhe moskërkimi apo humbja nga ndonjëri prej mjeteve të riparimit/dëmshperblimit nga secila Pale nuk do të kufizojë, parandalojë ose konsiderohet heqje dorë nga mjetet e tjera të riparimit/dëmshperblimit

NENI 21 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin e zbatueshëm. Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga ose në lidhje me këtë Kontratë, do të zgjidhen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi i së cilës është i ankimueshëm në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

NENI 22 DISPOZITA TË NDRYSHME

22.1 Vazhdimësia e detyrimeve

- 1 Çdo veprim ligjor ose e drejtë në favor të ndonjëres Pale sipas kësaj Kontrate dhe gjatë Periudhës Konçisionare që mund të rrjedhë nga çdo akt, mosveprim, dokument, çështje ose fakte të perfunduara ose harruara nga secila Pale për mbarimin të Periudhës Konçisionare për shkak të mbarimit të afatit të saj ose si rezultat i parashikimeve të kësaj Kontrate do t'i mbijetojë në mbarim të afatit të Periudhës Konçisionare apo të zgjidhjes së kësaj Kontrate, por në çdo rast pa cenuar parashikimet e pikës 18.3 më sipër.



22.2 Detyrimet te vecanta

- 1 Asgje ne kete Kontrate nuk ka per qellim te krijoje nje ortakeri apo perfaqesim midis Paleve te kesaj Kontrate.
- 2 Asnjera nga Palet nuk do te kete autoritetin te kryeje perfaqesime apo te veproje ne emer dhe per llogari te Pales tjetere, perveç parashikimeve te pikes 18.2.1.a me siper apo te angazhoje Palet tjetere ne cfaredo menyre.

22.3 Pavarësia e dispozitave

- 1 Nese cilado nga dispozitat/nenet e kesaj Kontrate vleresohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme per cfaredolloj arsyeje dhe nga cilado gjykate apo juridiksion kompetent, nje dispozite/nen i tille do te shfuqizohet pa sjellur pasoja per dispozitat qe mbeten. Nese nje dispozite/nen i kesaj Kontrate qe eshte themelore per permbushjen e qellimit te kesaj Kontrate gjykohet se eshte e pavlefshme ne cfaredo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do te fillojne menjehere negociatat ne mirebesim per ta rregulluar kete pavlefshmeri.

22.4 Ndryshimet e Kontratës

- 1 Kjo Kontrate mund te ndryshohet me marreveshje te shkruar te te dy Paleve.
- 2 Secila Pale mund t'i drejtoje Pales tjetere ne çdo kohe gjate Periudhes Koncesionare nje kerkese per ndryshim, të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar. Kerkesa duhet te jete me shkrim, e justifikuar dhe te permbaje fakte dhe rrethana konkrete per arsyet e ndryshimit.
- 3 Brenda 30 diteve nga paraqitja e kerkeses pala tjetere duhet te shprehet ne menyre te shkruar ne lidhje me pranimin ose refuzimin e ndryshimeve. Refuzimi i nje kerkese te tille duhet te bazohet mbi argumenta te arsyeshem Ne rast se pala tjetere nuk pergjigjet brenda 30 (tridhjete) diteve atehere palet do te fillojne negociatat per ndryshimin e kerkuar.
- 4 Çdo ndryshim i kesaj Kontrate apo Anekseve bashkelidhur, do te jete pjese perberese dhe e pandashme e kesaj Kontrate.

NENI 23 NJOFTIMET

- 1 Çdo lajmerim i dhene nga njera pale tjetres sipas kontrates duhet të behet me shkrim në adresen e specifikuar në kontrate.



2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Adresat për njoftime dhe komunikime sipas kësaj Kontrate janë:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve
Sheshi Skenderbej, Nr. 5
Tirana, Albania

Ne vëmendje të: Shkelqesise së Tij, Ministrit

Konçesionari:
AFTO Albanian Ferry Terminal sh.p.k
Durres, Porti Durres.


NENI 24 KOPJE DHE GJUHA E KONTRATES

Kjo Kontratë hartohet në 4 (kater) kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe gjuhën Angleze dhe versioni në gjuhën shqipe mbizoteron.

Autoriteti Kontraktor

Ministri i Punëve Publike dhe Transportit


Sokol Ollashi



AFTO Albanian Ferry Terminal Operator

Perfaqësuesi ligjor

Christian Baumberger



FRS Chartering Beteiligungsgesellschaft MBH

Christian Baumberger

Global Networks Albania sh.p.k

Jonid Cako

Jonid Cako